

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5961  
E hënë, 23 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Ali Ahmeti rizgjedhet kryetar i BDI-së



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

KOSOVA E PASLUFTËS F. 10

Shkruan:  
Izmi ZEKA



NJË MEMORIAL (MAUZOLE)  
PËR ADEM DEMAÇIN F. 12

Selatin  
NOVOSELLA



### AKTUALE



PSD-ja ZGJEDH NËNKRYETARËT,  
SEKRETARESHËN E  
PËRGJITHSHME DHE KRYESINË  
E RE F. 5



META: SERBIA T'I NDALOJË  
FUSHATAT KUNDËR INTEGRIMIT  
TË KOSOVËS NË NISMAT  
RAJONALE F. 2

NJË LISTË ÇËSHTJESH TË  
PAPËRFUNDUARA E PRESIN  
QEVERINË E RE F. 7

### EKONOMI

VITI 2020 TË KARAKTERIZOHET  
ME DIALOG MË TË FUQISHËM ME  
SEKTORIN PRIVAT F. 9

FLET PËR "EPOKËN E RE"  
REKTORI I UNIVERSITETIT  
"UKSHIN HOTI" NË PRIZREN,  
ISMET TEMAJ

## UNIVERSITETI 'UKSHIN HOTI'

## ËSHTË MOBILIZUAR PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE PËR RIAKREDITIM



Rektori i Universitetit 'Ukshin Hoti'  
në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet  
Temaj, në këtë intervistë dhënë  
gazetës "Epoka e re" ka folur për  
gjendjen dhe zhvillimet në këtë

universitet. Ai ka theksuar se janë  
mobilizuar dhe janë duke punuar për  
plotësimin e standardeve të  
akreditimit. Temaj ka shprehur  
optimizëm se do t'i tejkalojnë këto

sfida, mirëpo ka kërkuar të ketë më  
shumë mbështetje shtetërore, sidomos  
rreth buxhetit, pasi arritja e standardeve  
evropiane të cilësisë kërkon kohë dhe  
më shumë financa

KËTË JAVË MBAHET MBLEDHJA E PARË E LEGJISLATURËS  
SË SHTATË E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## A DO TE ARRIHET KËTË JAVË KOALICIONI LV-LDK?



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja  
Demokratike e Kosovës (LDK) kanë  
edhe katër ditë kohë që të pajtohen  
për bashkëqeverisje deri në seancën  
konstituive të Kuvendit e cila do të

mbahet të enjten në orën 15:00.  
Zyrtarët e këtyre dy subjekteve politike  
deri më tani nuk kanë dhënë shenja se  
mund të heqin dorë për kërkesat e  
tyre. Ndërsa njohësit e rrethanave

politike kanë bërë me dije për gazetën  
"Epoka e re" se LV-ja dhe LDK-ja  
duhet t'i tejkalojnë dallimet dhe  
të pajtohen për marrëveshjen e  
koalicionit

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Meta: Serbia t'i ndalojë fushatat kundër integrimit të Kosovës në nismat rajonale

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se Serbia duhet të ndalojë këtë fushatë kundër integrimit të Kosovës në nismat rajonale ose institucionet ndërkombëtare siç është, për shembull, edhe anëtarësimi në Interpol dhe nuk e kuptoj pse Serbia do të merrte një pozicion të tillë jo shumë të arsyeshëm dhe aspak konstruktiv



**TIRANË, 22 DHJETOR** - Në një intervistë të dhënë për televizionin boshnjak "O Kanal", presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se Serbia duhet t'i ndalojë fushatat kundër integrimit të Kosovës në nismat rajonale dhe institucionet ndërkombëtare. "Serbia duhet të ndalojë këtë fushatë kundër integrimit të Kosovës në nismat rajonale ose institucionet ndërkombëtare siç është, për shembull, edhe anëtarësimi në Interpol. Të gjithë në rajon janë të vetëdijshëm se krimi i organizuar është një nga problemet kryesore në të gjitha vendet tona dhe anëtarësimi i Kosovës në Interpol ndihmon

bashkëpunimin jo vetëm të Kosovës me Interpolin, por për të gjithë rajonin është një kontribut për ta luftuar krimin e organizuar nga ky rajon. Nuk e kuptoj pse Serbia do të merrte një pozicion të tillë, sipas meje, jo shumë të arsyeshëm dhe aspak konstruktiv. Sidoqoftë, unë besoj në dialog, në partneritet dhe shpresoj që së shpejti palët të ulen në tryezën e dialogut dhe ne jemi fuqishëm pro normalizimit të plotë të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë", u shpreh Meta.

I pyetur rreth minishengenit, nëse është kjo një mënyrë për të pasur bashkëpunim më të mirë në

rajonin e Ballkanit, Meta u përgjigj: "Ne kemi kaq shumë platforma rajonale bashkëpunimi. Çdo platformë rajonale bashkëpunimi, që është gjithëpërfshirëse, është e mirëpritur. Ky duhet të ishte një parakusht për të promovuar dhe konsideruar iniciativa rajonale

premtuese dhe të dobishme. Iniciativa që ndihmojnë bashkëpunimin tonë janë gjithmonë të mirëpritura, por jo duke provokuar debate të panevojshme, duke u përpjekur për të marginalizuar dikë ose një vend, apo t'i japësh protagonizëm dikujt

tjetër. Vetëm partneriteti dhe gjithëpërfshirja mund ta rrisin besimin mes vendeve, mes njerëzve dhe mund t'i reduktojë dhe eliminojë të gjitha barrierat qofshin ato legale, administrative apo burokratike në rajonin tonë".

## Basha: S'ka 'minishengen' pa i kërkuar Serbia falje Kosovës

**TIRANË, 22 DHJETOR** - Lideri i PD-së, Lulzim Basha e konsideron Shengenin ballkanik, si rrezik i heqjes dorë nga anëtarësimi me të drejta të plota në BE.

"Kjo nismë mund të bëhet pjesë e një skenari të "anëtarësimi minus" për vendet e Ballkanit Perëndimor, shpreh bindjen e thellë se Shqipëria nuk meriton të penalizohet për dështimet, abuzimet dhe paafësitë e kësaj qeverie që kanë çuar në errësimin e perspektivës evropiane për shqiptarët. Ne besojmë se Shqipëria nuk duhet të pranojë një ofertë alternative degraduese të integrimit por duhet të vazhdojë të synojë që të bëhet anëtare me të drejta të plota



në Bashkimin Evropian", u shpreh ai.

Basha deklaroi se nuk mund të ketë fqinjësi të mirë duke përfshirë Kosovën.

"Por ne gjykojmë se fqinjësia e mirë në Ballkanin Perëndimor kursesi nuk mund të arrihet duke

përfshirë Republikën e Kosovës. Prandaj e konsideroj të papranueshëm mos konsultimin e Qeverisë shqiptare me Kosovën për këtë iniciativë dhe bërjen pjesë të saj pa e kushtëzuar paraprakisht pjesëmarrjen e Shqipërisë me praninë e Kosovës. Këto qëndrime

bien ndesh me parimet e partneritetit strategjik për të cilat Qeveria e Shqipërisë është zotuar disa herë gjatë mbledhjeve me Qeverinë e Kosovës. Ato shkelin hapur marrëveshjen dytëditore për unifikimin dhe koordinimin e politikës së jashtme të dy vendeve tona", shpreh ai.

Basha shtoi se "samiti i minishengenit ndodhi në Durrës vetëm pak ditë pasi Serbia mohoi masakrën e Reçakut".

"Theksoj se i ashtuquajturit samiti i minishengenit ndodhi në Durrës vetëm pak ditë pasi Serbia mohoi masakrën e Reçakut, në vijim të përpjekjeve për të revizionuar historinë e krimit të saj shtetëror. Kjo

fyerje për Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar do duhej të ishte mjaftueshëm argument për të mos mbajtur atë aktivitet deri në kërkesën e ndjesës nga Serbia", shprehet ai.

Po ashtu, Basha shtoi se nisma e minishengenit ballkanik u propozua pas refuzimit të hapjes së negociatave në BE.

"Po kaq shqetësues është fakti se kjo nismë u propozua pas refuzimit të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, sepse lë përshtypjen e krijimit të një blloku të ri ekonomik dhe politik si alternativë apo sfidë ndaj Bashkimit Evropian", tha Basha.

## Ali Ahmeti rizgjedhet kryetar i BDI-së

**SHKUP, 22 DHJETOR (ER)** - Në një atmosferë impozante, që më shumë i ngjante një tubimi përmbyllës të fushatave zgjedhore, me prani të mijëra përkrasësve, Kongresi i Katërt Zgjedhor i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) që u mbajt të shtunën në Shkup, rizgjodhi njëzëri Ali Ahmetin në krye të këtij subjekti politik edhe për katër vjetet e ardhshme. Mbi 800

delegatë të pranishëm në Kongres, në këmbë dhe me duartrokite, votuan për përkrahje të Ali Ahmetit që t'i prijë Bashkimit Demokratik për Integrim në fitore të reja. Në Kongres u zgjodhën edhe anëtarët e organeve të reja partiake, si: të Kongresit të Vazhdimësisë, Këshillit Kombëtar, Komisionit Qendror Zgjedhor si dhe Këshillit të

Përgjithshëm, i cili më pastaj, në mbledhjen e vet konstituive, zgjedh kryesinë e partisë, nënkryetarët dhe sekretarët. Të pranishme në këtë kongres të BDI-së ishin edhe partitë politike LSDM, VMRO, NSDP, LDP, PDSH, RDK, TDP, PS, PD, LSI, PDK, Vetëvendosja, Nisma, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe të organizatave ndërkombëtare dhe të tjerë.



Këtë javë mbahet mbledhja e parë e legjislaturës së shtatë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

## A do të arrihet këtë javë koalicioni LV-LDK?



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë edhe katër ditë kohë që të pajtohen për bashkëqeverisje deri në seancën konstituive të Kuvendit e cila do të mbahet të enjten, në orën 15:00. Zyrtarët e këtyre dy subjekteve politike deri më tani nuk kanë dhënë shenja se mund të heqin dorë për kërkesat e tyre. Ndërsa njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se LV-ja dhe LDK-ja duhet t'i tejkalojnë dallimet dhe të pajtohen për marrëveshjen e koalicionit

partneritetin ta zëvendësoni me kushtëzim se: 'Nëse nuk bëjmë marrëveshje si duam ne, kalojmë në opozitë...' apo se LV-ja ka detyrim të formojë institucionet duke ua pamundësuar këtë skajshmërisht pandershëm me kushtëzime. Në rastin konkret, shumë më korrekte po tregohen partitë opozitare që po kërkojnë formimin e institucioneve, pa e kushtëzuar me asgjë, se LDK-ja e rënë në dashuri kokë e këmbë me veten e saj dhe duke jetuar nga e kaluara, përkatësisht duke e keqpërdorur edhe

personalitetin dhe varrin e Ibrahim Rugovë", ka thënë Shala. Ai ka vlerësuar se nëse këto parti e do ndryshimin, duhet t'i formojë sa më shpejt institucionet. "Nëse duan ndryshime, e kanë rastin, le t'i formojnë institucionet dhe le t'i grahin punës. Nëse punojnë mirë vetë populli do të kërkojë që presidenti të zgjidhet nga radhët e këtyre dy partive që, herë po duhen me një pasion të madh, kurse të nesërmen po e shajnë njëra-tjetrën duke i kujtuar shishet molotov,

sulmet me gaz lotsjellës, vezët e ziera dhe të paziera etj", është shprehur Shala. Së fundi edhe faktori ndërkom-bëtar ka shtuar presionin për formimin e institucioneve të reja. ShBA-ja, BE-ja dhe Britania e Madhe javën që lamë pas kanë kërkuar formimin sa më të shpejtë të qeverisë së re. Por, zyrtarët e lartë të LV-së dhe të LDK-së nuk kanë mohuar mundësinë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja nëse nuk pajtohen për bashkëqeverisje.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Seanca e parë e legjislaturës së shtatë do të mbahet këtë të enjte, por nuk dihet nëse do të ndodhë konstituimi i Kuvendit të Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të cilat në parim janë pajtuar për bashkëqeverisje, nuk kanë arritur ende një marrëveshje konkrete për koalicion qeverisës.

Në negociatat për qeverisje, LV-ja si subjekt fitues i zgjedhjeve të 6 tetorit ka bërë me dije se në marrëveshje nuk duhet të përfshihet posti i presidentit, ndërsa LDK-ja ka këmbëngulur se në marrëveshjen mes këtyre dy subjekteve politike duhet të përfshihet patjetër edhe posti i presidentit.

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se këto dy subjekte politike duhet të bëjnë koalicion, ndonëse kohët e fundit i kanë vështirësuar bisedimet. Shkëlzen Maliqi dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për "Epokën e re" se LV-ja dhe LDK-ja po e shantazhojnë njëra-tjetrën.

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se mund të ketë një marrëveshje LV-LDK për

bashkëqeverisje në çastet e fundit, duke shtuar se kjo marrëveshje mund ta ketë shijen e hidhët për palën që do t'i nënshtrohet shantazhit. "Alternativë praktikisht nuk ka, vetëm teorikisht mund të ndodhë që të nominohet një mandatar i dytë, që nuk është Albin Kurti. Alternativë reale janë zgjedhjet nëse nuk ka marrëveshje koalicioni. Besoj se marrëveshja do të arrihet por, ndoshta, me shijen e hidhët të imponimit për atë palë që do t'i nënshtrohet shantazhit", ka thënë Maliqi.

Ai beson se në marrëveshje në mes të këtyre dy partive do të përfshihet edhe çështja e postit të presidentit të ardhshëm. "Besoj se të paktën për presidentin do të ketë marrëveshje që atë ta propozojë LDK-ja, por që LV-ja ta konfirmojë si propozim të pranueshëm, nëse vlerëson se është personalitet që garanton përfaqësimin e interesave të vendit në përgjithësi dhe nuk është thjesht argat i LDK-së", ka thënë Maliqi.

Kurse analisti tjetër Behxhet Shala ka vlerësuar se këto dy parti janë të detyruara t'i formojnë institucionet. "Tash është shumë e pandershme dhe moralisht e papranueshme që



## Hekurudhat e Kosovës në veri, nën administrimin e Serbisë

Prishtinë, 22 dhjetor - Kosova vazhdon të mos e administrojë linjën hekurudhore në veri të Mitrovicës, ndërkohë që ka filluar zbatimin e projekteve për rehabilitimin dhe modernizimin e hekurudhave në përgjithësi. Linja ndërkombëtare hekurudhore që lidh Kosovën me Serbinë është nën administrimin e Serbisë dhe strukturave paralele serbe në Mitrovicë të Veriut, thonë autoritetet kompetente të hekurudhave në Kosovë. Agron Thaçi, kryeshef ekzekutiv

në kompaninë "Infrakos", kompani kjo që merret me infrastrukturën hekurudhore, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se linja hekurudhore në veri të Kosovës kërkon zgjidhje të shpejtë. Teknikisht kjo linjë hekurudhore, shton Thaçi, është në rregull, por që nuk menaxhohet nga autoritetet e Kosovës. "Ne operojmë deri në Mitrovicën e Jugut, deri tek Ura e Ibrit, ndërsa në pjesën tjetër operon një organizatë e Serbisë dhe ne momentalisht nuk jemi

përgjegjës për të operuar pa ndonjë marrëveshje apo urdhëresë. Le të shpresojmë që viti 2020 të jetë vit që do të zgjidhet ajo çështje në mënyrë që ne të kalojmë në menaxhimin dhe administrim edhe në atë pjesë të hekurudhës, pasi nuk ka kuptim që ne t'i kemi policët, doganierët tanë në Jarinjë të Poshtme, e atje të qarkullojë treni tjetër pa asnjë leje, pa asnjë pëlqim të autoriteteve të vendit", ka thënë Thaçi.



Flet për "Epokën e re" rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Ismet Temaj

# UNIVERSITETI 'UKSHIN HOTI' ËSHTË MOBILIZUAR PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE PËR RIAKREDITIM

Rektori i Universitetit 'Ukshin Hoti' në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka folur rreth gjendjes dhe zhvillimeve në këtë universitet. Ai ka theksuar se janë mobilizuar dhe janë duke punuar për plotësimin e standardeve të akreditimit. Temaj ka shprehur optimizëm se do t'i tejkalojnë këto sfida, mirëpo ka kërkuar të ketë më shumë mbështetje shtetërore, sidomos rreth buxhetit, pasi arritja e standardeve evropiane të cilësisë kërkon kohë dhe më shumë financa

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRIZREN, 22 DHJETOR -

"Epoka e re": Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren sivjet nuk ka pranuar studentë të rinj për shkak të problemeve me akreditim. Si është reflektuar kjo gjendje në universitetin që ju drejtoni?

Temaj: Fillimi i mandatit të rektorit në universitet nga ana ime është përcjellë me vështirësi. Në ditën e dytë të mandatit tim jam përballur me vizitën e grupit të ekspertëve ndërkombëtarë të caktuar nga Agjencia e Akreditimit për vlerësimin e institucionit për vazhdimin e akreditimit institucional. Ne jemi munduar që ta

prezantojmë gjendjen ekzistuese në mënyrën më të mirë të mundshme, mirëpo raporti i grupit të ekspertëve nuk ka qenë tërësisht negativ e as pozitiv, ndërsa Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka vendosur për mosakreditim institucional për një vit, në kohën kur pothuajse të gjitha programet janë riakredituar. AKA pak ka qenë kontradiktore në vendimet e veta, duke marrë parasysh edhe faktin se nuk është shqyrtuar fare ankesa e universitetit. Mendoj se mosakreditimi institucional për një vit ka qenë padrejtësi. Ndërsa universiteti vazhdon punën normalisht me vitet e dyta, të treta të katërta dhe në nivelin master në programet përkatëse.

"Epoka e re": Çka është duke bërë menaxhmenti i ri për tejkalimin e sfidave rreth akreditimit?

Temaj: Krahas punëve menaxheriale që i takojnë një rektorati, jemi mobilizuar për adresimin e kërkesave të AKA-së për riakreditim institucional. Pasi e kam marrë detyrën e kam vendosur si prioritet rritjen e cilësisë dhe ngritjen e universitetit bazuar në standardet e reja të caktuara nga Agjencia e Akreditimit në shtator të vitit 2018, posaçërisht të standardeve evropiane të arsimit të lartë. Kam caktuar një komision punues për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve ndërkombëtarë,



përmbushjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë. Duhet të rritet numri i punëtorëve në stafin akademik dhe administrativ. Na duhet buxhet më shumë për blerjen e librave universitarë, për përkthimin e librave universitarë, qasjen nëpër databaza të revistave shkencore dhe materialeve të tjera elektronike shkencore, për rritjen e buxhetit për hulumtime shkencore, për rritjen e buxhetit për bursa për studentëve, për investime kapitale dhe për shërbime të tjera që i nevojiten universitetit. Po ashtu, disa vërejtje rreth ndryshimeve statutare nuk janë në kompetencat tona dhe duhet që Kuvendi i Kosovës t'i thjeshtësojë plotësimet dhe ndryshimet statutare. Thjesht, qeveria duhet t'u përgjigjet pozitivisht kërkesave tona për rritjen e buxhetit në mënyrë që t'i tejkalojmë sfidat e akreditimit, përkatësisht rritjen e cilësisë dhe plotësimin e standardeve evropiane të cilat i ka vendosur Agjencia e Akreditimit në shtatorin e vitit 2018.

**"Epoka e re":** Si mendoni se realizohet kjo?

**Temaj:** Ne shumë shpejt me një shkresë do t'i drejtohem MASH-it, qeverisë dhe Kuvendit, në të cilën do t'i njoftojmë me hapat që janë ndërmarrë rreth riakreditimit institucional dhe mbështetjes që kërkojmë nga shteti për plotësimin e standardeve. Ne do t'i takojmë bartësit e institucioneve shtetërore dhe do t'ia prezantojmë gjendjen ashtu siç është, punët që janë bërë dhe që duhen bërë. Presim mbështetje shtetërore.

**"Epoka e re":** A mendoni që Universiteti i Prizrenit duhet të vazhdojë të funksionojë?

**Temaj:** Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren është universiteti i dytë në Kosovë, ndërsa universiteti i parë i themeluar nga institucionet e shtetit tonë, i vendosur në kryeqytetin kulturor e historik, në Prizren. Mbulon një regjion që është 1/3 e Kosovës dhe, për më tepër, qytetet e shteteve kufitare të regjionit. Po ashtu, Universiteti i Prizrenit është vazhdimësi e shkollës së lartë pedagogjike që ka nisur punën në vitin 1961, fillimisht si degë e Prishtinës, ndërsa më 1963 është pavarësuar dhe ka funksionuar si Shkollë e Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda". Kjo ka qenë me renome dhe është e njohur për cilësinë e kuadrove që ka nxjerrë.

**"Epoka e re":** Mbizotëron debati që të ketë fuzionim ose profilizim të universiteteve ekzistuese. Si i komentoni këto?

**Temaj:** Ne jemi për profilizim të universiteteve, që t'u përgjigjen kërkesave të tregut të regjionit që mbulojnë edhe me programe, edhe me numër të studentëve. UPZ e ka Fakultetin e

# PSD-ja zgjedh nënkryetarët, sekretarëshën e përgjithshme dhe kryesinë e re

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati dhe Zgjim Hyseni janë dy nënkryetarët e rinj të Partisë Socialdemokrate (PSD), kurse Teutë Rrusta është votuar sekretarëshë e përgjithshme e kësaj partie

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur të dielën mbledhjen e Këshillit Drejtues, me ç'rast janë votuar dy nënkryetarët, sekretarëshë e përgjithshme dhe anëtarët e tjerë të kryesisë, e cila ka 21 anëtarë dhe përfaqësim të barabartë gjinor 50/50.

Qëndron Kastrati dhe Zgjim Hyseni janë dy nënkryetarët e rinj, kurse Teutë Rrusta u votua sekretarëshë e përgjithshme e PSD-së. Po ashtu, gjatë mbledhjes u mbajt diskutim rreth orientimit të subjektit të ri dhe

është propozuar që në mbledhjen e radhës, që do të mbahet në gjysmën e dytë të janarit, të miratohet dokumenti që qartëson rrugën përpara.

PSD-ja para disa ditësh ka zgjedhur kryetarin e ri, Dardan Molliqaj, pas dorëheqjes së Shpend Ahmetit nga kjo pozitë. Ahmeti ka bërë me dije se vendimi për dorëheqje nga pozita e kryetarit të PSD-së vjen pas rezultatit të zgjedhjeve të 6 tetorit, ku kjo parti nuk arriti të fitojë asnjë ulësë në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, ai ka thënë se nuk do të jetë më pjesë e asnjë pozite në PSD, por do të jetë anëtar i thjeshtë i kësaj partie.

**KRYESIA E RE E PSD-SË**

Adea Batusha  
Adem Megjuani  
Albulenë Smaka  
Blinera Sheholli-Dudi  
Dren Kukaj  
Drilon Pireva  
Driton Çausi  
Eleonora Çeku  
Faton Topalli  
Frashër Krasniqi  
Kaqusha Jashari  
Natyra Kuçi  
Nol Nushi  
Shpresa Sejdiu  
Shqipe Kastrati  
Shyqiri Bytyqi  
Visare Gorani



Shkencave Kompjuterike, Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit që s'i ka asnjë universitet si ne, po ashtu edukimin që ka një traditë dhe që ofron mësimin në tri gjuhë, krahas disa drejtimeve në fakultetet e tjera, pastaj e kemi Fakultetin Ekonomik me programe komfor kërkesave të tregut dhe me numër modest, që më shumë prodhon kuadro cilësore sesa sasi. Po ashtu, Drejtimin e Gjuhës Gjermane

dhe Gjuhës Angleze dhe programet e tjera të Filologjisë, pastaj Fakultetin Juridik me numër modest të studentëve. Ne jemi për profilizim dhe do ta bëjmë këtë bazuar në afat kohor të riakreditimit të programeve.

**"Epoka e re":** Çfarë dëshironi të shtoni?

**Temaj:** Menaxhmenti dhe të gjithë punonjësit e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren janë mobilizuar për adresimit e

sfidave të akreditimit. Ne jemi duke punuar që t'i plotësojmë të gjitha kushtet e kërkuara. Presim mbështetje nga MASHTi, qeveria, pushteti lokal, Kuvendi, shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë në mënyrë që UPZ të vazhdojë të funksionojë dhe të marrë mbështetjen e nevojshme për zbatimin e standardeve të cilat kërkojmë punë nga ne, më shumë kohë dhe më shumë buxhet nga shteti.

ndërkohë së bashku me organet drejtuese janë caktuar grupet punuese dhe tani jemi në proces të finalizimit të punëve për adresimin e shumicës së rekomandimeve dhe kërkesave për riakreditim institucional. Për punën e kryer me përkushtim i falënderoj të gjithë punonjësit e universitetit. Vlen të theksohet se në këtë proces ndihmë të madhe na ka dhënë, me ekspertët e arsimit të lartë, programi "HERAS" që financohet nga Agjencia Austriake e Zhvillimit dhe bashkëfinancohet nga MASH-ti dhe zbatohet nga konsorciumi WUS Austri, ZSI dhe OeAD, të cilëve u jemi shumë mirënjohës.

**"Epoka e re":** A mund t'i tejkalojë këto sfida universiteti me kapacitetet e veta?

**Temaj:** Në raportin e grupit të ekspertëve ndërkombëtarë në njëfarë mënyre është rekomanduar riakreditimi institucional, mirëpo është theksuar se nuk është në dorën tonë adresimi i disa problemeve. Neve na duhet mbështetje institucionale nga institucionet qendrore dhe nga lokale për përmbushjen e rekomandimeve. Ajo që është më e rëndësishme, duhet të shtohet buxheti për universitetin. Qeveria duhet të parasheh në Ligjin e ri për Buxhet një fond të veçantë që i ndahet secilit universitet për

## Juniku goditet nga një stuhi me reshje të mëdha të shiut



Junik, 22 dhjetor (ER) - Komuna e Junikut dy ditët e fundit është goditur nga stuhi të forta dhe të reshura të mëdha të shiut. Nga stuhia dhe shiu janë shkaktuar dëme në rrjetin energjetik dhe lokacione të caktuar janë vërshuar.

Kjo komunë ka njoftuar se Drejtoria e Shërbimeve Publike të dielën ka vazhduar angazhimin për lokalizimin e dëmeve dhe evidentimin e zonave më të prekura nga stuhia dhe të reshurat e mëdha të shiut, duke bërë

përpjekje që situatën ta mbajë nën kontroll, që të mos ngjallet panik te qytetarët dhe ata të ndihen të sigurt. Komuna që drejtohet nga Agron Kuçi ka kërkuar nga qytetarët që të kenë kujdes në këto ditë të reshjeve të shiut.

## Lladrovci takon bizneset shqiptare në Slloveni

DRENAS, 22 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, gjatë qëndrimit zyrtar në Slloveni, ka takuar dhjetëra biznesmenë nga Kosova të cilët merren me veprimtari biznesore në këtë vend. Në takimin që ka pasur me biznesmenët i ka përgëzuar për punën dhe besimin që kanë krijuar në diasporë, në veçanti në shtetin e Sllovenisë. "Biznesmenët tanë kanë krijuar emër dhe besim kudo që kanë punuar në diasporë. Ashtu është edhe në Slloveni. Bashkëkombësit tanë me punë e përkushtim u integruan shpejt në vlerat dhe mundësitë që ofron shteti mik sloven dhe kanë bërë emër të

mirë këtu", ka thënë kryetari Lladrovci.

Ai ka treguar për punën që bën pushteti lokal në Drenas dhe ai qendror për t'i tërhequr investitorët. Ai ka theksuar se klima e të bërit biznes është shumë e favorshme duke ofruar kushte dhe lehtësira maksimale ligjore për ta ngritur veprimtarinë sidomos në Qendrën e Biznesit në Drenas. Kryetari Lladrovci gjatë takimit me bizneset në Slloveni i ka ftuar afaristët atje për vizitë në Drenas, për t'i parë kapacitetet dhe vullnetin e mirë për të investuar, duke përmendur pikat më tërheqëse për ta zhvilluar biznesin, duke potencuar edhe përkrahjen e plotë të komunës.



## Kurteshi-Emini: Për Tefikun e Nushin më së miri do të flasë historia



Gjilan, 22 dhjetor (ER) - Nën organizim të institucioneve komunale të Gjilanit dhe të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve është mbajtur akademi përkujtimore për nder të dëshmorëve Tefik e Hanumshahe Zymberi, të cilët me vendim të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, janë shpallur heronj të kombit.

Në këtë akademi, e cila është organizuar me rastin e ditëlindjes së 59 të Tefik Zymberit, ka folur edhe kryesuesja e Kuvendit Komunal, Shpresa Kurteshi-Emini, e cila duke i përshëndetur pjesëmarrësit në emër të kryetarit të komunës, Lutfi Haziri dhe institucioneve komunale, ndër të tjera, ka thënë se janë mbledhur sot këtu për ta kujtuar jetën dhe veprën e Tefikut dhe Hanumshahes dhe për t'i kujtuar të gjithë heronjtë dhe dëshmorët të cilët kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës. "Të flasësh për personalitetin e Tefikut dhe

Nushit, është përgjegjësi e llojit të vet dhe sigurisht se është edhe emocion, por më mirë se gjithkush ka folur jeta dhe vepra e tyre nëpër periudha të ndryshme kohore, duke e ngritur zërin për Kosovën në rrethanat më të vështira në të cilat është gjetur vendi ynë", ka thënë ajo.

Kurteshi-Emini ka thënë se këto personalitete përbëjnë dy nga figurat më të rëndësishme të kësaj periudhe dhe për të cilët më së miri do të flasë historia. "Po ashtu ne kemi obligim të punojmë që ta jetësojmë amanetin e Tefikut e Nushit dhe gjithë dëshmorëve të tjerë", ka thënë Kurteshi-Emini.

Çaste nga jeta dhe veprimtaria e heronjve Tefik e Hanumshahe Zymberi kanë rikujtuar edhe Shukri Buja, këshilltar i presidentit Thaçi, Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Ahmet Isufi, ish-komandant i ZOK-ut si dhe Ismet Tafili, bashkëveprimtar.

## Shtyhet aksioni për eliminimin e insekteve që sulmojnë pishat e Baballoqit

DEÇAN, 22 DHJETOR (ER) - Aksioni për eliminimin e insekteve që kanë sulmuar pishat në fshatin Baballoq të Deçanit është shtyrë për ditët e ardhshme. Ky aksion ishte paraparë të nisë të dielën por, për shkak të reshjeve të shumta të shiut,

është shtyrë. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka falënderuar qytetarët e Deçanit të cilët kanë shprehur interesim t'i përgjigjen pozitivisht aksionit për eliminimin e insekteve nga pishat. "Aksionin e organizuar për

sot në Sukën e Baballoqit, për shkak të reshurave të shumta të shiut, jemi detyruar ta shtyjmë për ditët në vijim. U jam mirënjohës të gjithë atyre qytetarëve të vullnetit të mirë që ishin sot së bashku me ne", ka thënë Ramosaj.



# Një listë çështjesh të papërfunduara e presin qeverinë e re

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Qeveria e re e Kosovës do të trashëgojë një listë të tërë çështjesh të pazgjidhura, thuhet në raportin e Grupit Ballkanik për Politika, ku pasqyrohen punët që i presin institucionet e reja, me theks të veçantë qeverinë.

Raporti shqyrton nevojat kryesore për reforma në fushën e administratës publike, përmbushjen e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) reformave të cilat dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA), çështjen e dialogut me Serbinë, politikën e jashtme, sistemin e drejtësisë, edukimin, shëndetësinë, mjedisin dhe zhvillimin ekonomik.

Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Kosovë, tha për "Radion Evropa e Lirë", se qeveria e re, e cila me gjasë do të formohet mbi bazën e koalicionit ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, do të trashëgojë shumë çështje të pazgjidhura.

Një nga çështjet të cilat përmenden në raport është edhe ajo e ligjeve dhe reformave të cilat janë kërkuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Rashiti thotë se janë dy-tre instrumente të fuqishme të cilat përmes bashkëpunimit me BE-në dhe proceseve, siç është përmbushja e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA), mund të bëjnë ndryshime thelbësore për funksionimin e institucioneve të Kosovës drejt përmbushjes së agjendës evropiane. "Qeveria e re duhet t'i vazhdojë reformat, ta luftojë korrupsionin, krimin e organizuar, paralelisht të lotojë të gjitha vendet anëtare që më në fund të merret vendimi për liberalizim të vizave. Pra, ka ende shumë punë në raport me BE-në dhe reformat dhe do të bëhej një gabim trashanik nëse qeveria e ardhshme vendos ta integrojë Ministrinë e Integritimit Evropian me atë të Politikës së Jashtme",



tha Rashiti.

Integrimi i ministrive është një nga qëllimet e IV-së dhe LDK-së që synojnë t pakësojnë numrin e ministrive. Grupi Ballkanik për Politika, mes të tjerash, thotë se institucionet duhet të kenë një përqendrim në agjendën e reformave, t'i marrin ato në pronësi dhe t'i vënë në qendër të politikëbërjes.

Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit dhe drejtësisë 2020 do të vazhdojë edhe nën qeverinë e re, thuhet në raport. Aty rikujtohet se qeveria në largim nuk arriti ta hapë kapitullin e 'ERA II' me Bashkimin Evropian, që ka të bëjë me Agjendën e Reformave Evropiane dhe parashikohet që kjo punë t'i bie qeverisë që do të formohet. "Ka të ngjarë, që 'ERA II' të lansohet menjëherë pas marrjes së detyrës nga qeveria e re, kështu që kjo çështje kërkon një kombinim të ri të veprimeve legislative dhe të iniciativave, në

mënyrë që faza e parë e procesit të reformave të ndërtohet dhe zbatohet plotësisht", theksohet në raport.

Rashiti konsideron se pa arritjen e një konsensusi ndërmjet udhëheqësve të institucioneve dhe partive politike nuk mund të ketë rezultate të prekshme në shumë çështje sfiduese për Kosovën. Marrëdhëniet e tensionuar politike në vitet e fundit kanë lënë shumë procese mbrapa, jo vetëm në raport me dialogun me Serbinë, por në shumë aspekte në reformat kryesore, në liberalizimin e vizave, në bashkëpunimin rajonal, në zhvillimin ekonomik, në luftën kundër krimin dhe korrupsionit, në integrimin e veriut. Pra, mosarritja e një konsensusi për çështje të caktuara mbetet shqetësimi kryesor", tha ai.

Ai thotë se nuk ka dyshim që Kosova i ka përmbushur kriteret e BE-së për liberalizimin e vizave, mirëpo me vetë faktin se nuk e

mori ende liberalizimin, Rashiti thotë se institucionet duhet të vazhdojnë me angazhime shtesë, sidomos në rrafshin e sundimit të ligjit, duke luftuar krimin dhe korrupsionin. Një angazhim i shtuar në përmbushjen e agjendës evropiane, sipas tij, do të siguronte argumente shtesë për shtetet brenda institucioneve evropiane që po kërkojnë përfshirjen e Kosovës në liberalizim të vizave. Ndërkaq, analisti Butrint Berisha nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike tha për Radion Evropa e Lirë, se Qeveria e re e Kosovës pas marrjes së mandatit, në radhë të parë duhet ta bëjë zbatimin e plotë të dokumentit "ERA" për të vazhduar tutje me hapat e tjerë në drejtim të përmbushjes së kërkesave të tjera. "Institucionet e Kosovës kanë mundur dhe është dashur që të bëjnë më mirë punën e tyre për t'i zbatuar obligimet që dalin nga dokumentet e BE-së. Qeveria e re në ardhje definitivisht

duhet që t'i përvjelë mëngët dhe në radhë të parë ta bëjë zbatimin e plotë të dokumentit 'ERAÇ'. Dhe, së dyti, ta finalizojë nënshkrimin e marrëveshjes 'ERA II' e cila ka filluar, por nuk është nënshkruar nga qeveria e fundit", tha Berisha. Hapësira e manovrimit për qeverinë e re, thuhet në raportin e Grupit Ballkanik për Politika, do të jetë e kufizuar nga realiteti socio-ekonomik, administrata joefikase, me mungesë të mëdha fondesh dhe me një sistem jofunksional partiak. Edhe 11 vjet pas shpalljes së pavarësisë, thonë analistët, Kosova dhe institucionet e saj po përballen me shumë sfida si në rrafshin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të ndërkombëtar. Analistët politikë konsiderojnë se ndër sfidat më të mëdha mbeten: sundimi i ligjit, përparimet në agjendën integruese evropiane, përmirësimi i imazhit të shtetit, zhvillimi ekonomik dhe luftimi i krimin dhe korrupsionit.

## Tomë Gashi: 15 dëshmitarë po intervistohen për rastin e Astrit Deharit



PRISHTINË, 22 DHJETOR- Ka më shumë se një javë që kur Policia e Kosovës ka filluar me intervistimin e 15 personave për rastin e vdekjes së Astrit Deharit. Në mesin e të intervistuarve do të jetë edhe ish-komandanti regional i Policisë së Kosovës, Nexhmi Krasniqi, të tjerët janë gardianë të qendrës së paraburgimit në Prizren si dhe staf mjekësor. Avokati i familjes Dehari, Tom

Gashi, ka thënë për "Ekonomia Online" se gjithë të intervistuarit do të jenë në cilësinë e dëshmitarit. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një urdhëresë apo një vendim me të cilin i ka autorizuar Policinë e Kosovës, që të marrin në pyetje mbi 15 dëshmitarë që shumica prej tyre janë të njëjtë, janë një pjesë e madhe gardian të qendrës së paraburgimit në Prizren, janë

stafi mjekësor që ka qenë në qendrën e paraburgimit në Prizren dhe risia është se do të merret në pyetje në cilësinë e dëshmitarit edhe ish-komandanti regional i Policisë së Kosovës, Nexhmi Krasniqi dhe sipas vendimit të Prokurorisë pastaj ata do të vendosin që pas grumbullimit të këtyre provave se si do të vazhdojë më tutje në rastin e vrasjes së Astrit Deharit", ka thënë Gashi.

# Tenderimi elektronik si masë parandaluese e korrupsionit me tenderë



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ofertat e tenderimit publik në Kosovë që nga fillimi i këtij viti janë duke u bërë vetëm përmes platformës elektronike, thonë përfaqësues të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Një formë e tillë ishte rekomanduar nga Bashkimi Evropian dhe shoqëria civile, si një nga mënyrat më efikase për ta parandaluar dhe luftuar korrupsionin me tenderë. Sami Uka, anëtar i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), thotë për Radion Evropa e Lirë se është hequr opsioni i dorëzimit të ofertës fizike, pasi që tashmë pranohen vetëm ato elektronike. "Prokurimi elektronik në formën 100 për qind ka filluar nga 1 janari i vitit 2019, ndërsa si proces ka filluar dy vjet më parë. Nga janari i këtij viti nuk ka më prokurim në letër, gjithçka është elektronik. Të

gjitha procedurat që mund të zhvillohen përmes prokurimit elektronik zhvillohen online", thotë Uka. Brenda vitit janë rreth 700 milionë euro të buxhetit të Kosovës të cilat shpenzohen përmes prokurimit publik. Vetëm në vitin 2018, sipas Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, janë nënshkruar 12 412 kontrata publike të udhëhequra me një vlerë prej 700 milionë eurosh. Prokurimi publik në raportet vendore dhe ndërkombëtare ishte konsideruar si burim i korrupsionit në Kosovë. Një vlerësim i tillë ishte dhënë vazhdimisht në raportet e progresit për Kosovën të Komisionit Evropian. Shumica prej bizneseve në vazhdimësi kanë pasur ankesa të shumta për parregullsitë që ndodhin gjatë procesit të tenderimit publik.

Në një studim të bërë së fundi nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë është theksuar se korrupsioni është shumë i pranishëm në aktivitetet e prokurimit publik, por 91 për qind e bizneseve të anketuara besojnë se prokurimi elektronik do të ndihmojë në luftimin e këtij fenomeni. Aplikimi i prokurimit elektronik, duke eliminuar në tërësi atë fizik, thotë Sami Uka, ka minimizuar mundësinë e keqpërdorimit dhe korrupsionit. "Kudo në botë është e vërtetuar se përdorimi i prokurimit elektronik zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit, pasi fillimisht eviton kontaktet fizike përmes operatorëve ekonomikë me zyrtarët, pastaj është mundësia e heqjes së dokumenteve apo dyshimeve për ndryshim të gjërave në tenderim. Të gjitha këto parregullsi janë minimizuar skajshmërisht dhe

nuk ka asnjë mundësi të tillë që më herët kanë mundur të jenë objekt i keqpërdorimeve dhe korrupsionit", thotë ai. Ekspertët e çështjeve financiare thonë se nga korrupsioni në prokurim është dëmtuar buxheti i shtetit dhe janë ofruar shërbime jo të mira nga operatorët ekonomikë, të cilët nuk kanë qenë të profesionalizuar për punët që kanë kryer. Milazim Abazi, ekspert i çështjeve financiare, thotë për Radion Evropa e Lirë se vetëm prokurimi elektronik nuk eliminon korrupsionin apo keqpërdorimet në tenderimin publik. "As prokurimi elektronik nuk mund ta luftojë korrupsionin. Korrupsioni luftohet nëse vetë sistemi, vetë njerëzit që e bëjnë sistemin, janë të vendosur ta luftojnë korrupsionin. Njerëzit e korruptuar në çdo lloj metode sillen të korruptuar, qoftë

edhe me sistemin elektronik të prokurimit. Duhet reformë më e thellë në prokurimin publik sesa prokurimi elektronik", thotë Abazi. Prokurimi publik përmes platformës elektronike krahasuar me atë fizik siç ka qenë në të kaluarën, konsiderohet të jetë më i qasshëm. Prokurimi elektronik nënkupton aplikimin online dhe jo atë fizik për një tender të caktuar. Nëse në një ofertë të tenderimit operatori ekonomik është dashur të paraqitet fizikisht me gjithë dokumentacionin e nevojshëm tek institucioni që ka shpallur tender publik, tani të gjitha i kryen përmes platformës online. Aty mund të njoftohen me kushtet e tenderimit, të marrë informacione dhe të njoftohet për vendimet deri edhe te përzgjedhja e operatorit ekonomik për një tender të caktuar.

## Kushtetuesja mund ta kërkojë amendamentimin e Ligjit për paga

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Ministri në detyrë i Administratës Publike (MAP), Mahir Jaghillar, ka thënë se ligji i ri për paga, i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, do ta rregullojë komplet sistemin e Administratës Publike nga aspekti i funksionimit, por edhe pagesave. Ai në një intervistë për "Ekonomia Online", ka thënë se deri më tani nuk ka ekzistuar ndonjë ligj themelor

sa i përket Ligjit të pagave, por vetëm rregullore sa iu përket vendimeve dhe shumë çështjeve të tjera lidhur me pagesat. Jaghillar ka thënë se nuk mund ta paragjykojë aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ekziston mundësia që të kërkojë amendamentimi nga Kuvendi i Kosovës në mënyrë që të bëhet një ligj i cili duhet të pranohet nga të gjithë. "Tash ne nuk

mund të paragjykojmë sepse ka raste kur Gjykata Kushtetuese ka pezulluar disa nene të ligjeve të caktuara edhe më herët. Ekziston mundësia që në këtë mënyrë të bëhet ose të kërkojë amendamentimi nga Kuvendi i Kosovës dhe në këtë mënyrë do të kompletohet dhe do të jetë një ligj i cili duhet të pranohet prej të gjithë palëve", ka deklaruar Jaghillari.





## Haradinaj arsyeton shpenzimet e Fondit Rezervë

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - Zyrtarë të Ministrisë së Financave në Qeverinë e Kosovës kanë bërë me dije se tashmë llogaria e Fondit Rezervë është zero.

Qeveria në largim e Kosovës tashmë ka shpenzuar më shumë se 6 milionë euro nga Fondi Rezervë i buxhetit për këtë vit. Ky Fond, sipas ligjit, mund të shpenzohet vetëm në raste urgjente dhe të paparashikuara. Vlera më e madhe e shpenzimeve, sipas të dhënave të publikuara nga qeveria, përfshin çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me destinimin e këtij fondi.

Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në detyrë të Financave në Qeverinë e Kosovës, ka thënë se tashmë llogaria e Fondit Rezervë është zero.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Fondi

Rezervë i Qeverisë së Republikës së Kosovës është fond i cili mbulon shpenzimet që nuk kanë linjë buxhetore dhe të cilat nuk janë paraparë fillimisht në buxhetin vjetor financiar. "Rëndom, në këtë kategori, për një vit financiar ndahen rreth 5 milionë euro, derisa varësisht nga vijueshmëria dhe nevoja, ky fond rimburohet, pas alokimeve buxhetore, të iniciuara nga Ministria e Financave dhe të aprovuara nga qeveria. Pothuajse për çdo vit, përfshirë këtu edhe vitet kur kanë qeverisur të tjerët, shuma totale e ndarjes qoftë fillestare, qoftë e mëvonshme, kalon mbi 7 milionë euro", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Haradinaj ka theksuar se nga ky fond janë ndarë mjete për t'i ndihmuar fermerët nga vërshimet, për t'i paguar orët shtesë të zjarrfikësve dhe situata të ngjashme, ku është dashur



vendim i shpejtë dhe gjithmonë me miratimin e qeverisë. "Këtë vit ky fond është shpenzuar pasi që është bërë ndarja e mjeteve për Shqipërinë, pas tërmetit me pasoja tragjike. Arsyeshmërinë, procedurat konform ligjeve të vendit dhe vendimet i bëjnë gjithmonë Ministria e

Financave dhe Qeveria e Kosovës. Çdo alokim dhe përcaktim është bërë me arsyeshmërinë më të lartë, sipas nevojave dhe në përputhje me ligjin", ka thënë Haradinaj.

Vetëm në mbledhjen e fundit të mbajtur më 17 dhjetor qeveria në detyrë e Kosovës nga Fondi

Rezervë ka ndarë 390 mijë euro për shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, 70 mijë euro për nevojat e Koordinatorit Nacional për Rini dhe Kulturë, kurse pjesën e mbetur në Fondin Rezervë prej 350 mijë eurosh qeveria ka marrë vendim ta kalojë në buxhetin e zyrës së kryeministrit.

## Viti 2020 të karakterizohet me dialog më të fuqishëm me sektorin privat



**EPOKA ERE** A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - Zhvillimet politike në gjysmën e dytë të vitit pas dorëheqjes së qeverisë ndikuan pashmangshëm në të arriturat e kufizuara dhe rezultate jo të kënaqshme në atë që u promovua si vit i zhvillimit ekonomik, derisa qeveria e re duhet t'i vazhdojë reformat në mjedisin e të bërit biznes. Kjo u tha në një konferencë të përbashkët për media të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Gjatë kësaj konference drejtuesit më të lartë të dy odave ekonomike folën për zhvillimet në aspektin ekonomik përgjatë

vitit 2019 si dhe prezantuan rekomandimet e tyre për vitin e ardhshëm.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, tha se, pavarësisht prej pritjeve për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik në vitin 2019, faktorë të ndryshëm kanë ndikuar negativisht në këtë aspekt, duke përmendur krizën politike si njërin ndër faktorët kryesor i cili, sipas tij, ka ndikuar negativisht në konfidencën e të bërit biznes si në mesin e investitorëve të brendshëm, ashtu edhe atyre të jashtëm. Ai ka shtuar se vonesa në konstituimin e qeverisë së re mund të krijojë dëme të pariparueshme për ekonominë e vendit.

Rukiqi, gjithashtu, theksoi se

temat e natyrës politike kanë lënë në hije reformat në politikat fiskale dhe ekonomike gjë e cila ka rezultuar me ngadalësimin e rritjes së eksportit dhe investimeve të huaja në vend.

Duke shpalosur rekomandimet për qeverinë e re, Rukiqi ka theksuar rëndësinë e dialogut më të fuqishëm ndërmjet sektorit privat dhe atij publik, por edhe promovimin e përbashkët të eksporteve të Kosovës. Ai, po ashtu, ka thënë se qeveria e re duhet ta shtyjë përpara themelimin e Gjykatës Komerciale, e cila tashmë ka marrë mbështetje nga të dyja odat ekonomike.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka vlerësuar për keqardhje mungesën e rezul-

tateve pozitive në fund të vitit. Në këtë aspekt, Zeka përmendi uljen për disa vende në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2020. Ndërsa si zhvillim më pozitiv ai përmendi renditjen e përmirësuar për pesë vende në Indeksin e Lirisë Ekonomike të publikuar nga Fondacioni Heritage i cili vlerëson zhvillimet në fushën e sundimit të ligjit, efikasitetit rregullator, madhësisë së qeverisë dhe tregut të hapur. Sa iu përket rekomandimeve për vitin 2020, rrjedhimisht për qeverinë e re, Zeka tha se ndër prioritetet kryesore duhet të jetë hartimi i një strategjie kombëtare të zhvillimit ekonomik si pikë orientuese dhe referuese për të gjitha vendimet e qeverisë dhe ministrive përkatëse. Ai më tej ka

thënë se përmbyllja e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë do të ndikonte në rritjen e stabilitetit politik dhe mundësitë për tërheqje të investimeve amerikane dhe investimeve të tjera të huaja jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë rajonin e Ballkanit perëndimor.

Çështje tjetër me prioritet e cila duhet të zë vend në agjendën e qeverisë ishte edhe ngritja e cilësisë së arsimit si dhe zvogëlimi i hendekut ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, derisa pikënisje në këtë aspekt duhet të jenë rezultatet e dobëta në raportin e PISA-së si dhe masat që vendet e ranguar më mirë në këtë raport kanë ndërmarrë në këtë aspekt.

# Kosova e pasluftës



Shkruan: Izmi ZEKA

Ditët po ikin dhe ne ende po përballemi me të kaluarën tonë historike, e cila përballje po merr dimensione të nduarshme më shumë për shkaqe politike sesa në aspektin historik dhe në interesat vitale të shqiptarëve.

Për njerëzit e dijes dua të potencoj disa argumente të cilat vlerësoj se janë të nevojshme për t'i konceptuar qartë proceset në të cilat ka kaluar Kosova gjatë dhe pas luftës së saj çlirimtare.

E para mendoj se është interes edhe i vet shkencës shqiptare se lufta e UÇK-së është përmbyllja më e mirë dhe e lavdishme që prej kohës së shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Në këtë kontekst nuk duhen shumë analiza, sepse vetë përmbyllja e luftës, ndihma nga aleatët tanë dhe në fund fitorja, përmbyllin kaptinën e fitores ndaj pushtuesit serb. Prandaj, nganjëherë sikur po lajthitim kur po shkruajmë dhe themi se do të konfirmohet edhe një herë lufta e UÇK-së. Nuk ekziston më konfirmim as edhe arsyetimi i asaj që është bërë.

Lufta e UÇK-së paraqet sublimin e shumë gjeneratave dhe mbyllet përfundimtare të historisë së Kosovës dhe lirisë së saj.

Nga ky sens gjërat që kanë krijuar rrethana të tjera historike nuk kanë nevojë për konfirmim, as edhe për mbrojtje të asaj vlere. E them këtë për dy arsye: E para, se aty u bë prerja historike, politike dhe strategjike dhe, e dyta, Kosova u çlirua nga dhuna serbe.

Asnjë hipotezë apo tezë shkencore nuk ka mundësi të shikojë ndryshe këtë pjesë të historisë. Pavarësisht mentalitetit tonë dhe historisë qindravjeçare e shkruar me doza të interferimit të kohës, UÇK-ja është kapitull i mbyllur në kuptimin e misionit të saj, kurse për studiuesit ka ende vend të shkruhet dhe t'i jepet lexuesit pasqyrë e veprimet konkret të saj. Si lëvizje dhe organizim luftarak

ajo tani i përket historisë më të lavdishme të shekullit XX.

Tërhoqa këto paralele për të mos humbur kohë në këtë zhvillim historik duke pasur argumentet e gjalla të cilat lidhen me prerje kohore nga aspekti gjeografik, historik, shkencor dhe në gjendjen e prekshme të shtetit të Kosovës.

Asgjë nuk arrihet pa një fillim. Çështja e tretë e pasluftës paraqet një kompozim tejet të vështirë në krijimin e shtetit dhe infrastrukturës së saj institucionale në gjithë shtetin e Kosovës.

Analiza sistemore e pasluftës besoj se ishte sfida më e madhe e udhëheqësve të kohës duke u gjendur përball dy realiteteve jo të natyrshme por të prekshme në terren.

Realiteti i parë ishte se Kosova u çlirua nga pushteti serb dhe filloj të administrohej nga përfaqësues të OKB-së. Ishte një lloj dualiteti në funksionalitetin e jetës në Kosovë.

UNMIK-u edhe pse kishte mision për të konsoliduar institucionet e Kosovës, shikuar nga syri i sotëm bëri disa gabime me apo pa qëllim që reflektimi dhe tabloja e mëvonshme tregoi se ka penguar zhvillimin e natyrshëm të ecjes dhe pragmatizmit në Kosovë. Kjo ishte vetëm njëra anë e medaljes së tyre.

Në anën tjetër ishin vendosur edhe institucionet shqiptare në kuadër të Qeverisë së përkohshme, e të cilat më shumë luanin rolin e një intermediatori në mes të realitetit të krijuar dhe të një institucioni të deleguar nga

OKB-ja.

Misioni i UNMIK-ut nga kjo largësi shihet se nuk kishte ndonjë qëllim substancial dhe fisnik për të mbrojtur interesat e qytetarëve të Kosovës, por më shumë për të krijuar kushte për një administrim të përkohshëm dhe ruajtjes së status quos në Kosovë.

Mbase edhe do të duhej të ishte e qartë edhe nga ne misioni i tyre.

Ata punonin me disa rregullore të cilat edhe vendosnin standarde të krijimit të infrastrukturës institucionale në Kosovë.

Ama nga ajo që u bë deri në vitin 2008 në Kosovë, pra nga kjo distancë të shumë për të dëshiruar. Administrata qoftë lokale dhe shtetërore pa një letërnjoftim të duhur dhe pa një ekzaminim të duhur u bë sistem i cili ruante në kontinuitet nga e kaluara e sistemit komunist në Kosovë.

Kjo edhe për faktin se ata që bënë ndryshimin dhe ndërruan epokë nuk e kishin përvojën dhe kualifikimin e duhur për vende të rëndësishme.

Unë po marr vetëm një fakt për të ilustruar se si dhe në çfarë mënyre u krijuan disa institucione në Kosovë. Gjyqësori dhe prokuroria ishin trashëgimi e sistemit të kaluar dhe të cilët në shumicë i kishin shërbyer pushtetit të ikur serb.

Qeveria e përkohshme dhe më vonë institucionet e dala nga vota e popullit në vend të anarkisë ligjore zgjodhën të keqën e dhimbshme, por sistemore në interes të Kosovës.

Një gjykatës apo prokuror duhej të përgatitej për 15 ose 20 vjet. Andaj

veprimet e asaj kohe ndoshta edhe mund të arsyetohen deri në një masë. Kjo që po shkruaj është vetëm njëra hallk e zinxhirit shtetëror se si u krijuan institucionet e arta shtetërore.

Ata që dolën nga lufta ishin të hendikepuar për shkak se nuk kishin përgatitjet adekuate dhe në këtë mënyrë mbetën jashtë sistemit institucional.

Kjo dhe nga analiza e sotme për disa arsye u leverdiste edhe institucioneve ndërkombëtare siç ishte UNMIK-u në Kosovë.

Arsyeja e parë ishte se ata dëshironin që përmes kësaj strukture mos të kemi një administratë të fuqishme.

Ndërkaq arsyeja e dytë që ishte edhe më e rrezikshme ishin shërbëtorët e pushtetit të kaluar dhe mbase kjo çështje u duhej atyre për të menaxhuar më mirë dhe për të luajtur lojën e djallit. Ky format i punës ka zgjatur pothuajse deri me shpalljen e deklaratës së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Përveç kësaj kishte filluar gjuetia e shtrigave duke linçuar çlirimtarët përmes shpifjeve të llojllojshme për të ndikuar në humbjen e autoritetit dhe kredibilitetit të tyre në popull.

Kosova udhëhiqej në bazë të rezolutës 1244 të OKB-së dhe kjo bënte që të sillen si pashallarë të vendit dhe veprimet e tyre ishin të pamatshme, por edhe të dëmshme për një krijesë të re çfarë ishte Kosova.

Ishte mbikëqyrje e rreptë ndërkombëtare dhe çuditërisht një luftë e pashpallur ndaj

ish-ushtarëve të UÇK-së. Kjo ishte pjesa e parë që pasojat e saj ende po barten te shteti dhe mentaliteti i qytetarëve tanë.

Pjesa e dytë që nuk është e parëndësishme qëndron në faktin se një pjesë e cila në heshtje deri në vitin 2008 kishin mbledhur dosje e çka jo për çlirimtarët ata prisnin rastin e parë që vullshëm t'i denigrojnë çlirimtarët përmes formave më perfide, duke i atakuar me vrasjet e pasluftës e të cilat asnjëherë nuk kishin gjetur përgjigje. Kjo sfidë që edhe sot e përcjell Kosovën ishte një skenar i bërë mirë nga qarqe që dirigjohen nga Serbia dhe argatët e saj në Kosovë.

Duke njohur mentalitetin tonë të robit dhe pushtimit të gjatë tek ne kishte njerëz me bollëk që u shërbenin kauzave të pista të argatëve të Serbisë.

Shërbimet e ndryshme por edhe disa mekanizma ndërkombëtarë që nuk e shihnin Kosovën si interes të tyre dhe mendjen e kishin te Serbia, investuan shumë në luftën e brendshme politike por edhe më drejtimin kah devalvimi i luftës çlirimtare.

Mbase edhe kjo luftë speciale nuk i arriti përmasat që donin qarqe të caktuara, ata filluan me të madhe luftën ndaj komandantëve dhe njerëzve me ndikim për të ulur fuqinë shtetformuese të Kosovës. Disa parti luajtën "mirë" në këtë drejtim duke i "masakruar" luftëtarët me shpifje e në anën tjetër duke mbrojtur luftën e UÇK-së.

Kjo ishte një sentencë e mirë për opinionin dhe që rezultatet do të shiheshin gradualisht. Luftën për pushtet e shndërruan në luftë ndaj atyre që filozofinë shtetërore e mbështetën mbi përpjekjet titanike për çlirim.

Duke parë se UÇK-ja si formacion çlirimtar kishte dhënë provimin dhe aty s' mund të prekej zgjodhën rrugë të tjera të cilat Kosovën e vunë përball dy realiteteve të thëna më lartë. Realiteti i formësimit të shtetit që nuk ishte substancial dhe realiteti i shtyrë nga forca të cilat përmes individëve të pastër duke i sakatosur shtrinë strukturën e cila kishte për qëllim përfitimet politike por edhe satanizimin e luftës së UÇK-së të mbështjell në petkun e individëve të saj.

(Autori është zëvendësministër i Punëve të Brendshme / Vizion)



## Arrestohet i mituri në Pejë, vodhi 2 500 franga dhe 500 euro nga çanta e një gruaje

PEJË, 22 DHJETOR (ER) - Policia e Kosovës në Pejë ka arritur të arrestojë një të dyshuar për vjedhje. I dyshuari i mitur, më datë 21.12.2019, pas mesnatës, kishte vjedhur nga makina çantën e një gruaje nga Shqipëria. Ajo në çantë kishte 2 500 franga dhe 500 euro, dokumentet e identifikimit, patentshoferin dhe pas-

aportën e Republikës së Shqipërisë. "Njësitë i hetimeve, Stacioni Policor Pejë, menjëherë ka vazhduar intensivisht me veprimet hetimore, me ç'rast më datë 22.12.2019 rreth orës 4:00 në një lokal është arritur të identifikohet, arrestohet i dyshuari i rastit të iniciuar të veprës së vjedhjes, shtetasi shqiptar kosovar (i

mitur), së bashku me dy persona të tjerë, të cilët janë të dyshuar lidhur me rastin për "Dhënie të ndihmës pas kryerjes së veprës penale", ka njoftuar policia në Pejë. I dyshuari me aktvendim të prokurorit të shtetit është ndaluar për 48 orë. Rasti me kallëzim penal dërgohet në Prokurorinë Themelore në Pejë.



## Presidenti i Kroacisë zgjidhet në balotazh

ZAGREB, 22 DHJETOR - Sipas rezultateve të exit pollot të televizionit kroat RTL, që janë mbledhur deri në orën 18.00, Zoran Milanović, kandidat presidencial nga SDP, ka marrë 29,58 për qind të votave, presidentja aktuale e HDZ-së, Kolinda Grabar-Kitarović 26,38 për qind, kurse kandidati pavarur

Miroslav Škoro, ka marrë 24,10 për qind të votave. Kroatët kanë votuar të dielën në zgjedhjet presidenciale, ku konservatorët në pushtet do të përpiqen të mbajnë pushtetin, pak kohë përpara se Kroacia të marrë për herë të parë presidenten e radhës të Bashkimit Evropian.

Rreth 3.8 milionë votues në Kroaci, anëtarja më e re e Bashkimit Evropian, kanë zgjedhur mes 11 kandidatëve, por vetëm tre prej tyre konsiderohen si konkurrentë të fortë. Edhe pse posti është kryesisht ceremonial në Kroaci, presidenti është komandant i ushtrisë dhe përfaqëson vendin në

arenën ndërkombëtare. Presidentja konservatore Kolinda Grabar-Kitarović ka kandiduar për një mandat të dytë, e sfiduar nga ish-kryeministri i majtë Zoran Milanović dhe këngëtari i krahut të djathtë Miroslav Škoro. Analistët parashikojnë se do të ketë nevojë për një balotazh



brenda dy javësh sepse asnjëri nga kandidatët nuk pritet të fitojë shumicën e nevojshme që në raundin e parë të zgjedhjeve.

# Trumpi i dërgon letër Putinit

Ministria e Jashtme ruse ka njoftuar të dielën se presidenti i ShBA-së Donald Trump i ka dërguar një letër homologut të tij rus Vladimir Putin për Marrëveshjen e Forcave Bërthamore të Shkallës së Mesme (INF)



WASHINGTON, 22 DHJETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) Donald Trump i ka dërguar një letër të shkurtër homologut të tij rus Vladimir Putin për Marrëveshjen e Forcave Bërthamore të Shkallës së Mesme (INF), tha të dielën ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov. "Trumpi ka dërguar një letër të shkurtër ku thotë se ata janë të gatshëm të vazhdojnë angazhimin e tyre në gjetjen e mënyrave për të kapërcyer problemet në marrëdhëniet tona", tha Lavrov në një paraqitje televizive, njofton rtk. Letra ishte në përgjigje të ofertës së Putinit për të vendosur një moratorium për zhvillimin e raketave të ndaluara nga marrëveshja bërthamore e intervalit

të mesëm, shtoi ai. ShBA-ja zyrtarisht braktisi marrëveshjen INF me Rusinë në gusht, duke pretenduar se Moska po shkelte marrëveshjen dhe kishte vendosur tashmë një lloj rakete të ndaluar, të cilën Kremli e mohon. Ndërkaq, Shtëpia e Bardhë ka njoftuar se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump bisedoi në telefon me kryeministrin japonez, Shinzo Abe lidhur me Iranin, Korenë e Veriut dhe tregtinë. Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Judd Deere nuk ka ndonjë detaj lidhur me bisedën e dy udhëheqësve për Iranin. Agjencia e lajmeve, Kyodo tha se biseda ndërmjet presidentit Trump dhe kryeministrit Abe ka zgjatuar një orë e pesëmbëdhjetë

minuta. Abe u ka thënë gazetarëve se biseda është zhvilluar me kërkesën e Trumpit. Ky diskutim ndërmjet dy liderëve më 21 dhjetor, vjen në ditën kur presidenti i Iranit, Hassan Rohani përfundoi vizitën dyditore në Japoni, ku ai kërkoi ndihmën e Tokios për të shpëtuar

marrëveshjen bërthamore të arritur më 2015 ndërmjet Iranit dhe fuqive botërore. Japonia është aleate kyçe e ShBA-së në Azi, por gjithashtu ka raporte të mira diplomatike dhe ekonomike me Iranin. Në të kaluarën, kryeministri japonez Abe, ka tentuar që të luajë rolin e

ndërmjetësit, për t'i përmirësuar marrëdhëniet ShBA-Iran. Tensionet ndërmjet Iranit dhe Shteteve të Bashkuara janë rritur, pasi vitin e kaluar, Trumpi tërhoqi Uashingtonin nga marrëveshja bërthamore. Që atëherë, ShBA-ja ka rivendosur sanksionet ekonomike ndaj Iranit.

## Turqia do të rrisë mbështetjen ushtarake për Libinë



ANKARA, 22 DHJETOR - Turqia do të rrisë mbështetjen e saj ushtarake për qeverinë e njohur ndërkombëtarisht të Libisë nëse është e nevojshme dhe do të vlerësojë opsionet e tokës, ajrit dhe detit, tha sot presidenti Recep Tayyip Erdoğan, pasi të dy palët nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ushtarak muajin e kaluar. Ankara zyrtare mbështet Qeverinë e Marrëveshjes Kombëtare (QMK) të Favez Seraj (Libyan Jamahiriya Arabe) në Libi dhe tashmë ka dërguar

furnizime ushtarake për QMK pavarësisht embargos së armëve të Kombeve të Bashkuara, sipas një raporti nga ekspertët e OKB muajin e kaluar, raporton Reuters. Turqia gjithashtu tha se mund të vendosë trupa në Libi nëse QMK bën një kërkesë të tillë. Qeverinë e Marrëveshjes Kombëtare (QMK) ka muaj që po lufton në ofensivën e forcave të Khalifa Haftar në lindje. Forcat e Haftarit kanë marrë mbështetje nga Rusia, Egjipti, Jordania dhe Emiratet e

Bashkuara Arabe. Muajin e kaluar, Turqia dhe QMK nënshkruan një marrëveshje për forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe një marrëveshje të veçantë të kufirit detar, i cili zemëroi Greqinë. Ndërsa Greqia pretendon se marrëveshja shkel ligjin ndërkombëtar, Turqia mohon pretendimet, duke deklaruar se synon të mbrojë të drejtat e saj në Mesdheun lindor. Erdogani tha të dielën se Turqia absolutisht nuk do të tërhiqet nga marrëveshja me Libinë.

## Presidenti i Afganistanit drejt një mandati të dytë pesëvjeçar

KABUL, 22 DHJETOR - Presidenti afgan, Ashraf Ghani duket se ka fituar një mandat të dytë pesëvjeçar, nisur nga rezultatet paraprake për zgjedhjet presidenciale të diskutuara të 28 shtatorit, që u bënë publike të dielën. Kryetarja e Komisionit të

Pavarur Zgjedhor publikoi rezultatet e vonuara në një konferencë me gazetarë në Kabul, duke vënë në dukje se Ghani kishte siguruar rreth 51 për qind prej mbi 1.8 milion votash. Haëa Alam Nuristani tha se rivali kryesor i Ghanit dhe partneri i tij i koalicionit në qeverinë e

bashkimit, shefi ekzekutiv, Abdullah Abdullah mori 39.52% të votave. Kandidatët e tjerë kishin marrë pjesën e mbetur të votave, tha ajo. Autoritetet e zgjedhjeve priteshin fillimisht t'i nxirrnin rezultatet paraprake më 19 tetor por akuzat për mashtrim nga

kandidatët, veçanërisht Abdullah, si edhe problemet teknike, e detyruan komisionin që ta shtynte disa herë shpalljen e tyre. Presidenti Ghani falënderoi në një fjalim në televizion Komisionin e Zgjedhjeve, qytetarët afganë dhe veçanërisht forcat e sigurisë,



që ndihmuan për organizimin e zgjedhjeve në rrethana të vështira.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (13)

# LIRIMI I NËNTË USHTARËVE TË UÇK-së NGA BURGU USHTARAK I NISHIT



LULZIM SAHITI

Në paraditen e 23 janarit të vitit 1999 ndodhi mrekullia e papritur. Nëntë të burgosurit shqiptarë i hipin në autobus, të cilët e kishin të ndaluar rreptësisht të flasin ndërmjet vete. Çdo njëri e kishte një polic (pa uniformë) ulur pranë vetes. Asnjëri nga të burgosurit nuk e kishin ditur nga po i çojnë, madje gjithnjë u kishte shkuar mendja për të keq se janë duke i dërguar për pushkatim ngaqë u mungonte çdo informatë nga jashtë. Në Kosovë kishin hyrë në pikën kufitare të Dheu i Bardhë nga e cila janë dërguar në ish-Kazermën Ushtarake "Zenel Hajdini" të Gjilanit, ku qëndrojnë një dhjetë minuta. Pastaj, nisen në drejtim të Ferizajt, kalojnë nëpër Shtime dhe ndalojnë në fshatin Shirokë të Suharekës të një fabrikë, ku më parë kanë qenë të vendosur refugjatët serbë. Aty i presin pjesëtarët e Misionit Verifikues të OSBE-së me veturat e tyre të portokallta. Fillimisht, në autobus ua zgjidhin duart dhe një nga një i zbresin të burgosurit duke i futur në vetura të OSBE-së. Dy-

tri vetura me ushtarët e liruar të UÇK-së, nisen në drejtim të Malishevës, por ende ishin të trishtuar dhe nuk besonin se janë liruar. Në postbllokun e parë të UÇK-së, në fshatin Dragobil të Malishevës ndalojnë kolonën e veturave të OSBE-së për legjitimim. Në këtë vend, nëntë ushtarët trima i gëzohen lirimit dhe e kuptojnë se tashmë janë në duar të sigurta, pra të liruar nga kriminelët serbë. Mandej, i dërgojnë në shkollë të Likocit (Skenderaj), ku i pritnin ushtarët dhe popullata civile e kësaj treve. Aty, zëdhënësi i UÇK-së Jakup Krasniqi i merr në shtëpi të vet, Enver dhe Xhavit Krasniqin, ku kanë ngrënë darkë dhe po atë natë nisen për në Kleçkë të Lipjanit. Nga aty së bashku me Ramë Bujën, vazhdojnë rrugën për Krojmir, kurse pjesa tjetër e ushtarëve shkojnë nëpër zonat ushtarake ku kanë shërbyer më parë.

## Tërheqja e 35 trupave të dëshmorëve dhe varrosja e tyre në Polac të Skenderajt

Për shkak të luftës, shumë familjarë të ushtarëve të vrarë, nuk kishin mundësi të tërheqin trupat e të vrarëve dhe kështu Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së së bashku me Zonën Operative të Pashtrikut vendosën që të formohet një këshillë i qytetarëve nga Krusha e Madhe si një ndër bazat më të forta të UÇK-së, që ishte afër Prizrenit.



Pllakë përkujtimore e ngritur te "Likenet e Hasit", në vendin e rënies së 41 dëshmorëve

Këshilli i Qytetarëve nga Krusha e Madhe (Rahovec) së bashku me Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë, më 19 dhjetor 1998 kanë bërë tërheqjen e 35 trupave të ushtarëve të vrarë, që ndodheshin në morgun e Spitalit të Prizrenit, dy prej të cilëve ishin të pidentifikuar.

Më 20 dhjetor të vitit 1998, trupat e 33 dëshmorëve, i varrosin me nderime ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve në Polac të Skenderajt, ndërsa dy trupat e pidentifikuar u varrosën më 22. dhjetor 1998 në Kleçkë. Pesë të rënë të tjerë të

cilëve u kishin humbur gjurmët në dëborën e madhe janë zbuluar nga bashkëluftëtarët e tyre, në maj 1999 gjatë operacionit "Shigjeta" të UÇK-së. Për shkak të luftimeve të ashpra dhe kushteve të rënda atmosferike, varrimi i Veli Ballazhit, Afrim Musliut, Selim Selimit, Besim Qarrit dhe Astrit Bytyqit u bë më 15 maj 1999 në Pashtrik nga bashkëluftëtarët e tij me nderime ushtarake. Pas përfundimit të luftës, dëshmorët e lirisë: Afrim Musliu dhe Selim Selimi nga Belinci u rivarrosën në vendlindjen e tyre më 4 korrik të vitit 1999. Ndërsa, trupat e dëshmorëve: Astrit Bytyqi dhe Besim Qarri u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve në Mollopolc. Më vonë, gjeësisht më 28 shtator 1999, trupat e shumë dëshmorëve të kësaj ane u rivarrosën në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në hyrje të Ferizajt, te vendi i quajtur "Mulliri i Kukës". Mbetjet mortore të dëshmorit Veli Ballazhi janë rivarrosur më 29 gusht 1999, në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pustenic. Në muajin tetor 1999, patologët i kanë identifikuar dy trupat që ishin varrosur në Kleçkë. Ata ishin dëshmorët: Gani Elshani dhe Ramadan Elshani. Ramadanin e rivarrosin në varrezat e njëjta, ndërkaq familjarët e rivarrosën Ganiun më 30 tetor 1999 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Krajkovë. Ndërsa, dëshmori Hazir Nezir Kryeziu (1955) nga Mleqani i

Malishevës ende ka mbetur në regjistrin e të zhdukurve. Pas zhvendosjes së dëshmorëve nga Polaci, më 27 qershor 2018, trupat e pesë dëshmorëve të komunës së Shtimes: Fadil Rashiti, Kadri Ademaj, Hafir Bajrami, Arben Hyseni dhe Xheladin Xheladini janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së në Shtime.

## Pllakë përkujtimore për dëshmorët e rënë më 14 dhjetor 1998 dhe luftëtarëve pjesëmarrës në këtë betejë

Në vendin e quajtur "Likenet e Hasit", më 14 dhjetor 2018 është bërë zbulimi i Pllakës Përkujtimore në nderim të komandantit të Brigadës 113 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Mujë Krasniqi dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij. Po ashtu janë skalitur në mermerë emrat e të gjithë pjesëmarrësve në këtë fushëbetejë të përgjakshme. Ndërsa pjesa nga kanë udhëtuar luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është pagëzuar "Shtegu i Lirisë". Investimet janë bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Të premten, më 14 dhjetor 2018 u bë transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Ushtri, e cila ndërlihet me një datë tejet të rëndësishme për historinë e Kosovës, ku pikërisht më 14 dhjetor të vitit 1998 në kufirin shqiptar ra dëshmori Mujë Krasniqi, së bashku me 40 luftëtarët e tij. (Vijon)



20 dhjetor 1998, pamje gjatë varrimit të dëshmorëve në Polac të Drenicës



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
 [Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA HALAL FOOD**

**PASHTETË PULE**

gluten free

100% mish purë

*cilësi e garantuar*

pa konservues

# NJË MEMORIAL (MAUZOLE)



Selatin NOVOSELLA

Adem Demaçi nuk ishte vetëm simbol i sakrificës, simbol i qëndresës, simbol i bashkimit kombëtar, simbol i vuajtjeve 28-vjeçare në burgjet e Jugosllavisë dhe Serbisë. Ai ishte shumë më shumë se kaq. Ai ishte vizionar i çështjes kombëtare, ideator dhe projektues i lirisë së Kosovës, për çka u shpërblye me çmimin më të lartë të Parlamentit Evropian për paqe - Saharov, me Dekoraten më të lartë të presidentit të Kosovës - Hero i Kosovës, (i vetmi i dekoruar për së gjalli), dhe Dekoraten e Presidentit të Shqipërisë

## NDERI I KOMBIT

1. Një popull e bëjnë të veçantë nga të tjerët jo vetëm sa është numerikisht i madh, çfarë standardi ekonomik ka, sa pallate, fabrika dhe rrugë moderne ka, çfarë ushtrie të fuqishme ka, të armatosur edhe me armë bërthamore etj. Por, atë e bëjnë të veçantë, në rend të parë, sa njerëz të veçantë ka akëcili popull. Ne, shqiptarët, gjatë historisë qindvjeçare, të mos lëshohemi më thellë dhe më larg, patëm personalitete që i dhanë emër popullit tonë dhe u bënë pjesë e historisë së përbotshme. Le të përmendim këtu vetëm disa prej tyre, duke marrë rrezikun që t'u hyjmë në hak shumë të tjerëve: Gjeneralin e gjeneralëve Gjergj Kastriotin - Skënderbeu; arkitekt Sinanin; dijetarin - Sami Frashëri; artistin Aleksandër Moisiu; kryeirrendentistin Hasan Prishtina; gjuhëtarin Eçrem Çabej; humanisten Nënë Tereze; këngëtarin Vaçe Zela; kritikun Rexhep Qosja; shkrimtarin Ismail Kadare; skulptorin Odhise Paskali; kryeherojin e UÇK-së, Adem Jashari dhe projektuesin e lirisë së Kosovë, Adem Demaçi.

2. Kur shokët e klasës të Adem Demaçit, si 10-vjeçar, në shkollën fillore, mësonin dhe bënin detyrat në klasë, ai e pyeste mësuesen e gjuhës serbe: "Pse, mësuese, nxënësit serbë nuk e mësojnë gjuhën shqipe siç e mësojmë ne nxënësit shqiptarë gjuhën serbe?!" Kur shkrimtari Dobrisa Qosiq i këshillonte kolegët e tij shqiptarë në Prishtinë, në vitet '50, që të fillojnë ta krijojnë një letërsi të re të shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi, në frymën e bashkim-vëllazërimit dhe patriotizmit jugosllav, i vetmi ishte Adem Demaçi që e kundërshtonte

shkrimtarin shovinist serb që kishte ardhur nga Beogradi në Prishtinë, se: "Shqiptarët e kanë letërsinë e tyre dhe s'kanë nevojë të krijojnë letërsi të re në Kosovë. Ne i kemi shkrimtarët tanë Naim Frashërin, Çajupin, Migjenin, Lasgushin etj!"

Kur kolegët shqiptarë të Adem Demaçit, në Kosovë, në vitet e '50 po i kushtonit poezi Titos dhe Sutjekës, Adem Demaçi shkruante romanin "Gjarpinjtë e gjakut" dhe apelonte:

"Jo atyre që janë trima  
Që ngrenë gishtin e kimit,  
Por atyre që janë trima

Që shtrijnë dorën e pajtimit!"  
Kështu, shkrimtari i talentuar, vetëm 22-vjeçar, si vizionar dhe parashikues i proceseve historike, porosiste shqiptarët të mos ia kthejnë pushkën njëri-tjetrit, por atyre që i kishin pushtuar!

3. Adem Demaçi, duke vazhduar të jetë krejt ndryshe nga të tjerët, kishte folur hapur për padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve para shokëve, kolegëve dhe miqve në Prishtinë, ku punonte si redaktor i letërsisë botërore në "Rilindje", në Universitetin e Beogradit, ku studioje si dhe më vonë në Fakultetin Juridik në Prishtinë ku kishte vazhduar studimet.

Pas refuzimit që Adem Demaçi të anëtarësohej në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, (propozim që i ishte bërë përmes një kolegu shqiptar në "Rilindje"), ai ishte bërë tepër i bezdisshëm për pushtetin jugosllav e posaçërisht atë serb në Prishtinë dhe Beograd.

E vetmja mundësi që pushtetit serb i kishte mbajtur që t'ia ndalonte shkrimet dhe botimet e talentit të rrallë që po lindte, që t'ia pamundësonte kritikën e tij kundër pushtetit të kohës, që t'ia mbyllte gojën kryengritësit syapatrembur i kishte mbetur që, gjithsesi, ta çonte Adem Demaçin prapa grilave.

4. Andaj, më 19 nëntor 1958, Adem Demaçi burgoset me akuza se ai kishte bërë propagandë armiqësore kundër Jugosllavisë, kundër Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe kundër Josip Broz Titos. Akuza parashihet dënimin deri në 20 vjet burg të rëndë.

Të gjitha ato që Adem Demaçi i kishte thënë sa kishte qenë në "liri", tashti, në UDB-në famëkeqi i përsëritë. Në deklaratën e tij gjatë hetimeve ai tha se: "Pushteti jugosllav po planifikon t'i mbyllë shkollat në gjuhën shqipe; pushteti po i torturon shqiptarët me pretekst se kanë armë të fshehta duke mbytur shumë prej tyre; pushteti po bën presion që shqiptarë të shpërngulen nga trojet e tyre në Shqipëri e sidomos në Turqi. Andaj, shqiptarët për t'iu shpëtuar këtyre padrejtësive duhet të përpiqen, deri në

kryengritje të armatosur, dhe të bashkohen me atdheun e tyre - Shqipërinë".

Në muajin shkurt të vitit 1959, në fjalën e tij të fundit të gjykimit, Adem Demaçi nuk ankohet, por kritikon, nuk mbrohet, por sulmon, duke dëshmuar se popullit shqiptar po i lindte një vizionar, kurse pushtetit jugosllav dhe atij serb, një kundërshtar i përpjetëm. Ai deklaroi: "Nëse Jugosllavia dhe Serbia vazhdojnë me këtë politikë ndaj shqiptarëve në Jugosllavi dhe nuk lejojnë që ata të bashkohen me atdheun e tyre - Shqipërinë, nuk do të ketë paqe në Jugosllavi as në rajon. Nëse Serbia vazhdon me këtë politikë një ditë do të bëhet shkaktare e shpartallimit të krejt Jugosllavisë dhe, në fund, do të mbetet edhe pa Kosovën!"


5. Pasonjë edhe dy gjykime të tjera kundër Adem Demaçit. I dyti në vitin 1964, si themelues i organizatës atdhetare "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", me ç'rast dënohet me 15 vjet burg të rëndë së bashku edhe me rreth 200 bashkëveprimtarë të tij. Ndërsa në gjykimin e tretë, në vitin 1975, dënohet, përsëri, me 15 vjet burg të rëndë. Dënimet i vuan në burgjet e Podujevës, Prishtinës, Mitrovicës së Sremit, Pozharevcit dhe të Stara Gradishkës.

Gjatë vuajtjes së 28 vjetëve burg të rëndë, biografët e Adem Demaçit kanë konstatuar se ai kishte vuajtur 6 vjet e 5 muaj qeli të rënda, në vetmi absolute dhe shumicën e kësaj kohe në qelitë nën dhe.

Për t'i vënë një kapak të artë jetës së tij, Adem Demaçi emërohet nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - përfaqësues i përgjithshëm politik i kësaj Ushtrie, e vlerësuar edhe nga ekspertë ushtarakë botërorë si gueilja më e suksesshme e shekullit XX.

6. Ndonëse Adem Demaçi në Kosovën e lirë, më 1999, nuk u zgjodh as deputet, as ministër, as kryeministër, as kryeparlamentar, as president i vendit, ai ishte shumë më shumë se kaq. Jo vetëm pse, për këta 20 vjet lirie dhe 11 vjet pavarësi të Kosovës, kishim me qindra deputetë, me dhjetëra ministra dhe një duzinë kryeministrash, kryeparlamentarësh dhe presidentësh, por të gjitha këto pozita nuk do ta bënin Adem Demaçin më të dashur, më të çmuar dhe më të vlerësuar sesa vetëm rruga e tij jetësore dhe vepra unike kolosale që ka lënë pas vetes.

Po të isha poet ose këngëtar do të thosha "po ku ka poezi që e zë brenda Adem Demaçin" dhe "po ku ka këngë që e zë brenda Adem Demaçin!" Rrjedhimisht, po ku kishte pozitë politike, shtetërore dhe qeveritare që do ta zinte brenda Adem Demaçin?!



7. Për personalitetin e papërsëritshëm të shekullit XX, Adem Demaçin, kanë thënë se ai ishte, është dhe do të jetë: legjendë e gjallë, hero i gjallë, aromë atdheu, metaforë lirie, strateg i rrallë, vizionar largpamës, projektues lirie, frymëzues brezash, krenari kombëtare, nderi i kombit, bashkues brezash, humanist i madh, i panënshtuar i durueshëm, figurë unike kombëtare, martir i kombit, histori e gjallë, ideator i Lëvizjes Kombëtare, udhërrëfyes lirie, artikulus i ëndrrave të shqiptarëve, personalitet i pazëvendësueshëm, sfida e madh, korife, yll polar, idol brezash, zë i ndërgjegjes kombëtare, inspirues i idesë çlirimtare, emër që flet vetë, vullkan i pashuar, feniks shqiptar, përmendore e gjallë, burrë me palcë Shqipërie, flakadan i lirisë, figurë e spikatur, burrë legjendar, libër i hapur, luftëtar i pathyeshëm, i burgosuri numër një në Jugosllavi, zë i fuqishëm i UÇK-së, pajtues i rrymave politike, udhëheqës shpirtëror, flamurtar betejash, emblemë kombëtare, titan i

pathyeshëm, marthonamaku shqiptar, zë i guximit, zë i shpresës, zë i sakrificës etj.

8. Adem Demaçi, përveç veprës kombëtare që ka lënë si trashëgimi, porosi dhe amanet për brezat që do të vijnë, ka lënë 11 vepra letrare (8 romane, 1 dramë historike, 1 përmbledhje me tregime dhe 1 libër me poezi). Po ashtu, ka lënë edhe 13 vepra publicistike të pabotuara (4 libra me analiza, 5 libra me intervista, 1 me debate, 1 me letra, 1 me fjalime, 1 me kujtime).

E tërë kjo trashëgimi kolosale do të jetë e përfshirë në kolonën prej 40 veprave të titulluar: 'Veprat e zgjedhura të Adem Demaçit dhe për Adem Demaçin', të cilat është duke i përgatitur Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës (ShBPK), për çka janë njoftuar me kohë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari, Kadri Veseli. E tëra kjo veprimtari e madhe dhe projekt kapital do të kryhet me sukses pasi që në lokalet e ShBPK-së janë

# PËR ADEM DEMAÇIN



grumbulluar dhe sistemuar: 27 vepra të botuara dhe të ribotuara të Adem Demaçit; 28 monografi kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit; 433 libra të cilat janë referencë edhe për Adem Demaçin; rreth 11.000 faqe me dokumente arkivore, artikuj të gazetave dhe revistave me shkrime të Adem Demaçit dhe të autorëve të tjerë kushtuar atij; 120 CD me video dhe audio material për Adem Demaçin; 25 këngë kushtuar Adem Demaçit; 25 piktura kushtuar, vizatime dhe skica kushtuar Adem Demaçit; 155 poezi kushtuar Adem Demaçit; mbi 200 fotografi të ndryshme; 30 çmime, dekorata, shpërblime, mirënjohje dhe falënderime për Adem Demaçin.

9.

Ndonëse Adem Demaçi ishte kryetar i organizatave atdhetare para se të burgosej tri herë radhazi, ndonëse ishte kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, ndonëse ishte kryetar i Partisë Parlamentare të Kosovës para çlirimit, kurse pas Vitit të Madh

1999, ishte drejtor i Bordit të RTK-së dhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, si dhe Kryetar Nderi i Përjetshëm i ShBPK-së që nga themelimi, në vitin 1996 deri në shkuarjen në amshim. Me plot arsye ShBK-ja është identifikuar me Bacën Adem Demaçi ashtu siç është identifikuar Ai me këtë shoqatë.

10.

Andaj, plotësisht është e kuptueshme që idetë dhe propozimet për ndarjen e shumicës së çmimeve, dekoratave dhe shpërblimeve të dakorduara për Adem Demaçi të kishin buruar, pikërisht, nga ShBPK-ja, siç janë: Dekorata Nderi i Kombit i ndarë nga presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë; ndarja e titullit dr. Honoris Kausa nga rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova; emërtimi i sheshit më të mirë në Prishtinë sheshi "Adem Demaçi", nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ku në përvjetorin e shkuarjes së Bacës Aden Demaçi, më 26 korrik 2019, kryeministri i

Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vënë gurthemelin e shtatores së Adem Demaçit, si dhe caktimi i vendit të varrimit për Bacën Adem, në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.

11.

Qeverisë së ardhshme të Kosovës, e dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019, dhe kryeministrit të ardhshëm që, sipas të gjitha parametrave, do të jetë Albin Kurti, përveç obligimeve dhe angazhimeve të panumërta që i presin, besojmë se do t'i mbështesin dy projektet kapitale përkitazi me jetësimin e veprës kolosale të Adem Demaçit: e para që ta mbështesin financiarisht projektin për botimin e 40 veprave të zgjedhura të Adem Demaçit dhe për Adem Demaçin dhe e dyta ta ndërtojnë Memorialin, përkatësisht Mauzoleun ku do të pushojë përjetësisht shpirtndrituri, vizionari dhe i papërsëritshmi - Baca Adem Demaçi!

Memoriali duhet të ngritet në sheshin "Adem Demaçi", në

parcelën në sipërfaqe prej 140 ari, në hyrje të Prishtinës. Ndonëse sipërfaqja aktuale e sheshit "Adem Demaçi" ka 83 ari, sipërfaqja tjetër, që aktualisht përfshin pompën e derivateve "Iliria", me infrastrukturë ndihmëse prej rreth 60 ari, do të jetë hapësirë e mjaftueshme për Memorialin Adem Demaçi.

Në këtë memorial, përveç varrit të Adem Demaçit, i cili duhet të zë hapësirën më madhe, qendrore, të memorialit, aty duhet të vendoset dhe sistemohet e tërë trashëgimia e Adem Demaçit: dokumentet arkivore, programet politike të organizatave atdhetare që i ka udhëhequr Adem Demaçi, botimet dhe ribotimet e veprave të Adem Demaçit, dorëshkrimet e pabotuara të konfiskuara nga policia me rastet e burgosjeve të Adem Demaçit, librat, revistat dhe gazetat ku ka shkruar Adem Demaçi dhe të tjerët për të, dekoratat, çmimet dhe shpërblimet e Adem Demaçit, fotografitë e burgjeve ku ka vuajtur dënimet Adem Demaçi, fotografitë familjare dhe me personalitetet e panumërta kombëtare dhe ndërkombëtare, fotografitë nga pamja e varrimit të

Adem Demaçit etj.

Siç dihet, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, pas vdekjes së Adem Demaçit, më 26 korrik 2018, ka marrë disa vendime për përjetësimin e jetës dhe veprës së Adem Demaçit, njëra prej të cilave është edhe ngritja e shtatores së Adem Demaçit në Sheshin që mbanë emrin e tij në Prishtinë.

Jo vetëm për arsyet që u thanë më lart, Adem Demaçi meriton që varri i tij të jetë në një memorial të veçantë. Duhet të theksohet edhe një moment dhe rrethanë e rëndësishme përkitazi me parakushtet e ngritjes së memorialit Adem Demaçi në hapësirën e theksuar më lart edhe për faktin se në njërin prej takimeve të Këshillit për ngritjen e shtatores së Adem Demaçit, në të cilin mermin pjesë edhe djali i Adem Demaçit, Shqiptari, dhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës dhe menaxheri aktual i pompës së derivateve të naftës "Iliriani", Selim Pacolli, i cili deklaroi: "Flas edhe në cilësinë e nënkryetarit të Komunës së Prishtinës si dhe në cilësinë e menaxherit të pompës 'Iliriani', se nëse ka nevojë të rritet hapësira e sheshit 'Adem Demaçi', pajtohem që sipërfaqja e pompës me infrastrukturën ndihmëse t'i bashkëngjitet sheshit 'Adem Demaçi', në mënyrë që ky shesh të jetë ashtu siç e ka merituar Baca Adem Demaçi".

12.

Shumica e njerëzve vdesin. Vetëm disa të paktë ndërrojnë jetë. Në mesin e atyre shumë të rrallëve që ka ndërruar jetë është edhe Baca ynë Adem Demaçi. Si do të duket kjo jetë e dytë e Adem Demaçit (sepse jetën e parë se si duhej të jetohej ai e ka dëshmuar vetë), varet prej tre faktorëve: një - varet prej bashkëveprimtarëve të Bacës Adem që me kujtimet e tyre ta mbajnë të gjallë praninë e Bacës në mesin tonë; dy - varet prej institucioneve të shkencës, të arteve dhe të kulturës sesa do të dinë ta studiojnë trashëgiminë kolosale, polivalente dhe poliedrike të Adem Demaçit dhe tre - do të varet prej institucioneve shtetërore të Kosovës, për themelimin e të cilave Adem Demaçi vetëm nuk kishte vdekur dhe ringjallur sesa do t'i mbështesin projektet e nduaruara që Adem Demaçi ta vazhdojë jetën e dytë, pa praninë fizike në mesin tonë.

Pres nga bashkëveprimtarët e Bacës Adem Demaçi, nga punëtorët e shkencës, artit dhe kulturës, që t'i shprehin mendimet dhe vlerësimet e tyre për këtë ide - propozim dhe, në fund, pres që institucionet e shtetërore të Republikës së Kosovës, secili nga prizmi dhe kompetenca e tyre, ta realizojnë këtë ide për ngritjen e memorialit Adem Demaçi.

Intervistë me José Carlos Rodrigo Breto, autorin e librit "Ismail Kadare: Stratagjema e madhe"  
nga BIDATZ VILLANUEVA

# José Carlos Rodrigo Breto: Veprat e Kadaresë, shkëndijë lirie në terrin totalitar

Romanet e Kadaresë, ku ndërthuren rishkrimi i miteve të traditës klasike, gojëdhënat popullore, historitë përrallore dhe personazhet e kallura në botë të ndërlikuara dhe origjinale, ku mund të shihen gjurmët e Dantes, Kafkës, Servantesit, Homerit apo Eskilit, e bëjnë këtë autor shqiptar një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të shek. XX, dhe krijimtarinë e tij letrare një nga më vendimtare e këtij fillimshkulli. Kjo intervistë do të na bëjë të mundur ta njohim akoma më tepër shkrimtarin e madh shqiptar



Ti i quan veprat e Kadaresë si një shkëndijë lirie në "gjinin e territ totalitar". Çfarë do të spikatje prej veprës së tij?

Vepra e Kadaresë është një luftë e pareshtur për të arritur botimin, duke iu kundërvënë politikës së Regjimit, madje herë-herë duke vënë në rrezik edhe vetë jetën e tij. Prandaj ai thur strategjinë e vet për t'ia hedhur censurës. Tirania e Hoxhës vuri në lëvizje një Stratagjemë të Madhe mashtrimesh, gënjeshtresh e krimesh dhe, që të mund ta kallëzonte këtë në veprat e tij, Kadareja e pa veten të detyruar të thurte një poetikë të mirëfilltë rezistence, për të cilën bën fjalë eseja ime. Romanet e Kadaresë nuk janë vetëm një ushtrim i zgjuarsisë letrare, por gjithashtu janë edhe një shembull i dredhive dhe hileve me anë të të cilave mund t'ia hedhësh një censori. Gjetja e modeleve klasike për t'i portretizuar këto situata të ndaluara, e shndërron veprën e Kadaresë në një ese të përhershme mbi atë çka na bën njerëzorë, duke vënë në skenë, me stilin e Shekspirit, Dantes apo Servantesit, personazhe të paharrueshme, të cilët, shpesh herë, na përfaqësojnë të gjithëve.

**Mund të themi se Kadareja e ka përdorur letërsinë si një armë politike?**

Jo saktësisht politike. Mua nuk më pëlqen asnjë lloj letërsie politike apo e komprometuar, besoj se një gjë e tillë përfundon duke e kalbur xunkthin e cilësisë letrare. Letërsia e Kadaresë, thënë më mirë, është një letërsi rezistence. Rezistence ndaj një situatë kriminale dhe kriminit të Shtetit. Ai ka nevojë të shprehet dhe të rrëfejë gjëra të rrezikshme që në Shqipërinë e

Hoxhës nuk pranohen. E vërteta është se Kadareja kufizohet të shkruajë, ose të përpiqet të shkruajë me normalitet, në vendin më jonormal në botë: këtu qëndron rezistenca e letërsisë së tij. Pastaj, e lexuar prej të tjerëve, kjo rezistencë që është produkti i nevojës për frymëmarrje dhe për t'u shprehur, mund të merret si një armë politike, por kjo tashmë ndodh në këndvështrimin e interpretimit, jo në zanafillën e krijimit të veprave, të cilat, më shumë sesa nevojës për kundërshtim, i binden nevojës për t'u shprehur lirish. Ama është e qartë, përpjekja për të krijuar lirish në atë Shqipëri, detyrimisht, ishte ushtrimi i kundërshtimit, i rebelimit. Dhe, së fundmi, gjithashtu i rezistencës politike.

**Ti e nis librin duke treguar lidhjet që ekzistojnë mes Shqipërisë dhe Luftës civile spanjolle; domethënë, përmend luftëtarë shqiptarë që luftuan në anën e republikanëve. A është më e ngushtë nga ç'mendohet marrëdhënia mes dy vendeve?**

Ç'është e vërteta, ne në Spanjë dimë shumë pak për Shqipërinë. Përkundrazi, ata po e kanë një imazh të spanjollëve, kjo, në një pjesë të mirë, falë letërsisë. Shkrimtari Petro Marko ka shkruar një roman për ato Brigadat Ndërkombëtare me të cilat luftoi në betejën e Qytetit Universitar, dhe e titulloi veprën në spanjisht: "Hasta la vista". Një shprehje me të cilën, ende edhe sot, disa shqiptarë tashmë të moshuar të befasojnë sapo marrin vesh që je spanjoll.

Pastaj është imazhi që kemi ne për Shqipërinë, që për shumë njerëz është një vend i mbyllur dhe që për shumë kohë qe kokëfortësisht komuniste. Shumë prej nesh, për një kohë të gjatë,

kemi pasur përshtypjen e një Shqipërie që Kadareja ka dashur të na japë në veprat e tij, ku shkrimtari, neve që e kemi lexuar, na e ka ndërtuar imazhin kombëtar të atij vendi nëpërmjet letërsisë së tij; ç'është e vërteta, gjithmonë kishim besuar se qasja më e madhe mes dy vendeve gjendej tek ai pirati që suri rob Servantesin, i quajtur "Mami shqiptari".

**Kadareja kërkoi strehim në Francë. Ti gjithashtu përmend edhe romane që në Shqipëri u censuruan, pasi vinin në dyshim pushtetarët. A ekzistojnë sot, ashtu siç thua ti, romane "të papërshtatshme" si ato të asokohe?**

Patjetër. Çdo roman që përmban një të vërtetë letrare të sinqertë mbi këtë botë ku jetojmë, vetvetiu është një roman i papërshtatshëm. Ai shënjestron drejtpërdrejtë disa ligësi që vazhdojnë të qëndrojnë në gjë të

shoqërisë, sepse ashtu e duan pushtetarët. Këtyre pushtetarëve nuk u pëlqen aspak që të dalë në dritë Stratagjema e Madhe që kanë ngritur. Ata parapëlqejnë që ne t'i mbajmë sytë tjetërkund, por kryesisht letërsia është ajo që merr përsipër detyrën t'i zbulojë ato dredhi, shpesh herë me rreziqe të mëdha për ata që e shkruajnë. Të jesh shkrimtar në Rusinë e Putinit, është tejet e vështirë, ose në Shtetet e Bashkuara aktuale, ku po ngrihen zërat kundër Trampit dhe jo pa reprezalje. Edhe pse me vështrim të parë mund të mos duket kështu, të shkruash, varet se çfarë, në disa vende që pandehen demokratike, mund të sjellë pasoja të padëshiruara. Përshtypja e lirisë është kaq, thjesht një përshtypje, të cilën ata gjithashtu duan të na krijojnë; e gjithë kjo është pjesë e atij Mashtrimit të Madh që vazhdon të zgjasë në kohë. Të jesh

shkrimtar, me mish e me shpirt, do të thotë vizatosh në ballë një shënjestër, një element tejet i rrezikshëm dhe aspak i këshillueshëm.

**A ngjallin kërkimi të shoqëria jonë, Shqipëria dhe historia e saj? Apo vepra jote mund të shërbejë si nxitëse për këtë gjë?**

Shqipëria po nis të zgjojë një interes turistik të spanjollët. Me t'u gjendur atje, përplasja kulturore është aq e mahnitshme sa udhëtarët kanë nevojë të dinë më tepër për historinë e atij vendi; Shqipëria është një vend që ka nevojë t'i shpjegohet udhëtarit dhe në atë çast zë fill interesi për kulturën dhe për letërsinë shqiptare. Çdokush që udhëton në Shqipëri nuk i reziston dot kërkimit, më pas, shpjegimeve për gjithçka i kanë parë sytë. Kësisoj, pak nga pak, ngjallet interesi për Shqipërinë dhe, patjetër, shpresoj që eseja ime të jetë një ndihmë sado e



vogël. Pamja e Shqipërisë që paraqes unë në libër është një pamje reale e asaj çka unë kam parë atje; bëhet fjalë për një vend që përpigjet të modernizohet me hapa të mundimshëm, ndërsa në të bashkëjetojnë traditat më rrënjësore. Kjo krijon situata vërtet joshëse dhe kërshërindjellëse. Shpresoj që ata lexues, të cilët nuk kanë qenë kurrë në Shqipëri, ta shkojnë në mend një vizitë në këtë vend pasi ta lexojnë esenë time. Padyshim, do të më pëlqente të isha një shtytsë e marrëdhënëve hispano-shqiptare.

**Përpos kësaj, Kadareja ishte ai që të shtyu ta vizitonte Shqipërinë. Çfarë zbulove atje? A të ndihmoi ta kuptoje më mirë autorin?**


Udhëtimi në Shqipërinë e Kadaresë ishte thelbësor, domethënë, në Shqipërinë e romaneve të tij dhe në Shqipërinë e vegjëlisë së tij: në qytetin e tij të lindjes, Gjirokastër. Duke e vizituar atë qytet aq të bukur, por aq të ashpër, të thiktë e të gurtë, e kupton akoma më mirë botën imagjinare të shkrimtarit dhe ngjyrimet e prozës së tij. Unë, jo vetëm në qytetin e lindjes së Kadaresë, zbulova atë Shqipërinë që shfaqet në veprat e tij, veçanërisht në Tiranë, e cila e ka një këmbë në shkuarën dhe tjetrën në të ardhmen. Qe një vizitë e paharrueshme që kam dëshirë ta përsëdyt, sepse pata rastin, dhe kjo qe gjëja më e mirë, të endesha në skenarin e romaneve të Kadaresë sikur të isha duke jetuar në një dioramë të veprave të tij; kjo, për studiuesin e kujtudo shkrimtari, është një privilegj i rrallë.

**Çfarë ka nënkuptuar Kadareja për ty?**

Për mua, zbulimi aq fatlum i Kadaresë, nënkuptoi pajtimin me Letërsinë e Madhe, vërtetimin se është e mundur të krijohet një vepër e pasqyrore në kushtet më të papërshtatshme, dhe më shtyu të bëhesha kraha-

sues. Për një pjesë të mirë të asaj çka jam si krahasues, i detyrohem Kadaresë dhe rrjetës së ndërlikuar të lidhjeve që ai ka vendosur me vepra të tjera, me mite dhe me botë imagjinare, të cilat shfaqen në romanet e tij. Për mua, Kadareja qe, në një moment vendimtar, kthimi te krahet e letërsisë, rizbulimi i

dashurisë për librat, madje rikthimi në universitet për të studiuar një degë të re; prandaj i detyrohem, këmbë e krye, kthimin tim në krahasues. Një pjesë të madhe të gjithë këtij detyrimi, jam munduar ta kthej dhe t'ia kthej me këtë ese, e cila thelbësisht është një ushtrim i letërsisë së krahasuar. /exlibris



Përktheu nga spanjishtja Erion Karabollu

Marrë nga: <https://www.todoliteratura.es/noticia/50251/entrevistas/jose-carlos-rodrigo-breto:-mi-descubrimiento-de-kadare-tan-afortunado-supuso-la-reconciliacion-con-la-gran-literatura.html>



## Pesë drama të Jeton Nezirajt botohen në Itali

Libri "Il volo sopra il teatro del Kosovo / 5 plays" që përfshinë 5 drama të dramaturgut kosovar Jeton Neziraj, është botuar këtyre ditëve në Itali, nga shtëpia e njohur e botimeve teatrore Editoria & Spettacolo. Pesë dramat e Nezirajt, të përfshira në këtë botim janë: "Fluturimi mbi teatrin e Kosovës", përkthyer nga Kamela Guza, "Lufta në kohën e dashurisë", përkthyer nga Valbona Malaj, "Border Ballkan", përkthyer nga Liljana Cuka Maksuti, "Peer Gynti nga Kosova", përkthyer nga Valbona Xibri dhe "Një shfaqje teatri me katër aktorë...", përkthyer nga Liljana Cuka Maksuti.

Për "Il volo sopra il teatro del Kosovo / 5 plays", një parathënie të zgjeruar ka shkruar edhe historianja dhe shkrimtarja e njohur italo-amerikane, Anna Di Lellio. Më herët në Itali, nën kujdesin artistik të Anna Maria Monteverdi-it dhe të Monica Genesin-it, është botuar edhe drama tjetër e Nezirajt, "Shembja e kullës së Ajfelit". Dramat e Nezirajt, të prod-

huara nga Qendra Multimedia dhe me regji të Blerta Nezirajt, janë prezentuar tashmë disa herë në Itali, në festival e teatro të ndryshme. Së fundi, në teatrin e famshëm Piccolo teatro di Milano është prezentuar shfaqja "Një shfaqje teatri me katër aktorë...". Ndërkohë që, kuruar dhe nën drejtimin artistik të Anna Maria Monteverdi, televizioni i njohur Italian, RAI para dy vitesh ka shfaqur edhe një dokumentar mbi punën e Jeton Nezirajt dhe të Qendrës Multimedia. /KultPlus



## Filmi "Klithma" shpallet fitues i çmimit Best Cinematography në Bosnje

Filmi i shkurtër artistik "Klithma" në regji të Korab Lecajt, është shpërblyer me çmimin Best Cinematography në konkurrencën e filmave të shkurtër, të cilën e ndan çdo vit Asociacioni i Kinematografeve të Bosnjes dhe Hercegovinës.

Lajmin e ka bërë të ditur regjisori i filmit, Korab Lecaj, ku përmes një statusi në Facebook shpreh kënaqësinë për lajmin e marrë.

**Statusi i plotë:**

"Sapo e mora një lajm fantastik nga Bosnja.

Filmi ynë "Klithma", është shpërblyer me çmimin "BEST CINE-



MATOGRAPHY" në konkurrencën e filmave të shkurtër të cilën e ndan çdo vit Asociacioni i Kinematografeve të Bosnjes dhe Hercegovinës.

Sigurisht ky çmim i është ndarë drejtorit të fotografisë së filmit "Klithma", Almir Dikoli.

Urime Almirrit dhe të gjithë ekipit! Më poshtë e keni një deklaratë të shkurtër të njërit prej anëtarëve të jurisë për filmin "Klithma", të cilën sapo e kemi pranuar nga Bosnja: "Filmi "Klithma" është një film i mrekullueshëm me një temë serioze, veçanërisht për popujt e Ballkanit".

Alen Drljevic, regjisor nga Bosnja/anëtar i jurisë"



E jashtëzakonshme

## Gaforret e kuqe "pushtojnë" rrugët, shkaktojnë trafik automjetesh

Miliona gaforre të kuqërremta kanë bllokuar rrugët e Ishujve të Krishtlindjes, territor ky që ndodhet në Oqeanin Indian, që njihet për



temperaturat e larta. Gaforret shihen duke tentuar t'i shpëtojnë të nxehtit afrikan.

FOTO E DITES



Një zjarrfikës shihet duke shuar zjarrin në një pronë në Balmoral, 150 kilometra në jug-perëndim të Sidneit. /AFP

E rrallë

## Biznesmeni paguan faturat e energjisë elektrike për 36 familje të varfra

Një biznesmen në Florida ka shlyer faturat e 36 familjeve që rrezikonin të mбетeshin pa energji elektrike gjatë sezonit të festave. Pasi mori faturën e tij të energjisë, Michael Esmond i erdhi ideja t'u hiqte një pjesë të stresit fqinjëve. Ai kontaktoi me kompaninë e energjisë në qytetin Gulf Breeze, ku ai jeton, për të pyetur se kush ishin banorët që nuk kishin paguar faturat dhe kërkoi të paguheshin në emër të tij. Kur shkoi të



paguante faturën e tij të gazit dhe energjisë, 73-vjeçari zbuloi se furnizimet me energji elektrike do të ndërpriteshin në disa shtëpi nëse nuk paguheshin deri më 26 dhjetor. Në total, Esmond pagoi 4 600 dollarë për t'i ndihmuar 36 familje në komunitetin e tij prej 6 000 banorësh.

## BARSOLETA E DITËS



Shkon gjakovari në ëmbëltore:  
- Më falni, sa kushton trileqja?  
Kamerieri:  
- Një euro e gjysmë.  
Gjakovari:  
- Atëherë sillma një njëleqe.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

### The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

### FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

### FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

**Regjia:** James Mangold



### Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

**Regjia:** Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




**DASHI**

Mos lejoni që egoja juaj t'ju bëjë mosmirënjohës dhe të mos pranoni ndihmën që ju ofrojnë të tjerët. Do jetë një strategji e mirë për të ecur para me një çështjen tuaj që doni ta realizoni.



**DEMI**

Frika juaj është e vetmja gjë që po ju mban larg çdo gjëje. Është koha të ndryshoni! Nëse jeni beqar, rrezikoni dhe flisni me atë person. Ftojeni atë në një takim, nuk është fundi i botës.



**BINJAKËT**

Gjithçka është në dorën tuaj, edhe buxheti. Një kontroll i mirë i parave është mënyrë e shkëlqyer për të organizuar jetën tuaj. Nëse kurseni pak më shumë do shihni që rezultatet do jenë të mëdha.



**GAFORRJA**

Një nga marrëdhëniet tuaja më të reja mund të mos ketë një fillim të lehtë dhe të mbarë. Por dije se ka shumë potencial dhe ja vlen çdo përpjekje që bëni për të ditën e sotme.



**LUANI**

Keqkuptimet ndodhin, por yjet thonë se nëse do mund të komunikosh me dikë që je ftohur, do arrini t'i rregulloni gjërat. Jini të hapur me ta dhe tregojuni atyre që keni dëshirë të keni një marrëdhënie të mirë dhe të ngrohtë me të.



**VIRGJERESHA**

Dikush në familjen ose grupin tuaj social po kalon disa çështje të rënda për të cilat ju mund të mos jeni të vetëdijshëm. Mënyra se si po reagojnë ndaj këtyre problemeve, mund të ndikojë edhe në marrëdhënien tuaj dhe komunikimi mund të bëhet shumë i vështirë.



**PESHORJA**

Jini shumë fleksibël sot sepse do ju duhet. Dikush në jetën tuaj është gati t'ju ndryshojë përditshmërinë tuaj. Ata do ju bëjnë një ftesë mjaft interesante.



**AKREPI**

Kohët e fundit, një mik është përpjekur për ta bërë jetën e tij më të mirë dhe është shumë e admirueshme që ju po e mbështesni kaq shumë.



**SHIGJETARI**

Nëse dikush po vë në dyshim idealin tuaj, ju keni çdo të drejtë të vini në dyshim motivet e tyre! Është koha që ju të jepni aq sa merrni.



**BRICJAPI**

Kjo mund të jetë një shenjë pakënaqësie ose nuk po sfidoheni aq sa ju dëshironi. Nëse gjërat bëhen shumë të lehta për një kohë të gjatë, ju mund të humbni avantazhin tuaj.



**UJORI**

Nëse e keni ndjerë vetën mjaft të përgjumur tre pasditet e fundit, atëherë është koha të merrni një rutinë të re. Ndryshime të vogla, veçanërisht kur i bëni ato në fillim të ditës, mund të kenë një efekt të madh në pjesën tjetër të ditës.



**PESHQIT**

Është shumë e rëndësishme që disa njerëz duhet të bëhen të vetëdijshëm për këtë person dhe t'i kushtojnë më shumë rëndësi, prandaj bëheni ju të ndodhë kjo gjë.

## Hilary Duff nervozohet me paparacët



Aktorja Hilary Duff është nervozuar shumë me tre paparacë për të cilët ka folur përmes një storie të postuar në "Instagram", ku i ka kritikuar ashpër pse ata e kanë ndjekur hap pas hapi gjithë ditën atë dhe dy fëmijët e saj. "Unë jam duke shëtitur së bashku


me dy fëmijët e mi dhe kudo që shkoj paparacët më vijnë pas. Dy burra, tre, por aktualisht njëri nga ta është duke u larguar me shpejtësi matanë rrugës. Ata thjesht po më përcjellin mua dhe fëmijët e mi kudo që po shkojmë", ka thënë aktorja e "Lizzie McGuire".

## Hilary Duff martohet për herë të dytë



Hilary Duff është zyrtarisht e martuar. Aktorja i dha fund beqarisë duke i thënë "Po" partnerit të saj prej tre vjetësh Matthew Koma. Ata mbajtën një ceremoni private në kopshtin e banesës së tyre të shtunën. Çifti mirëpriti në jetë një vajzë në tetor të vitit 2018 dhe njoftoi fejesën në maj të këtij viti.

"Ishte një festë dashurie, një ceremoni e vogël dhe private në shtëpinë e saj me miqtë dhe familjen", ka thënë një burim për "Just Jared". Hilary u lidh me kompozitorin në janar 2017, një vit pasi u finalizua divorci i saj nga Mike Comrie. Ajo dhe Comrie kanë një djalë, Lucan, shtatëvjeçar.



## Kate Moss vishet si mashkull në Miami

Kate Moss ka publikuar një set fotografik të nxehtë në plazhin e Miamit, po ajo është e parë e veshur si mashkull. E veshur me një beretë në kokë

dhe një pallto oversize, modeluesja tregon gjoksin zbuluar. 45-vjeçarja super modele, duket më e bukur dhe sensuale se asnjëherë.

## Ndahen Channig Tatum dhe Jessie J



Aktori i njohur dhe këngëtarja Jessie J janë ndarë pas një viti lidhje të dashurisë. Një burim i afërt ka pohuar për "US Weekly" se ata janë ndarë, por se akoma janë miq të

mirë. Ish-çifti për herë të parë u panë bashkë në tetorin e vitit të kaluar. Tatum e konfirmoi lidhjen në nëntor kur postoi një fotografi të yllit pop në skenë në "Royal Albert Hall".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Futbollisti më i mirë në Superligë, i panevojshëm për Feronikelin

Kastriot Rexha është vlerësuar i panevojshëm nga skuadra e Feronikelit, e cila në edicionin e kaluar, me golat dhe ndihmën e tij, arriti të shpallet kampion dhe fitues i Kupës. Rexha fitoi tri çmimet kryesore në futbollin e Kosovës, kurse vendimin e klubit nga Drenasi e ka quajtur të çuditshëm. Sulmuesi më i mirë në vend ka konfirmuar se mezi po pret të fillojë sfidën e re në kërkim të titujve të rinj



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMERI**

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - KF Feronikeli nga Drenasi javë më parë njoftoi se nuk llogaritet në shtatë lojtarë, në mesin e të cilëve edhe sulmuesin kryesor Kastriot Rexha. Ky vendim është dukur i çuditshëm nga drejtuesit e kampionëve, pasi Rexha ishte lojtari që në shumicën e ndeshjeve ishte vendimtar dhe njëri nga kontribuuesit më të mëdhenj në garën për titull dhe për Kupë. Pavarësisht kësaj, Rexha u vlerësua lart nga trajnerët e Superligës, pasi fitoi tri çmime të premtën në shpalljen e "Laureatëve 2019" nga Federata e Futbollit të Kosovës. Sulmuesit prishtinas i takoi çmimi

i futbollistit më të mirë, çmimi i golashënuesit të vitit dhe ai ishte edhe në formacionin më të mirë. Lidhur me këto çmime, Rexha të dielën për "Epokën e re" i ka falënderuar bashkëlojtarët dhe klubin e "Niklit", të cilët i konsideron bashkëmeritorë për suksesin e arritur. "Jam shumë i lumtur me trofetë e fituar dhe mendoj se i kam merituar plotësisht, sepse kemi pasur një edicion të shkëlqyeshëm me Feronikelin. Falënderoj bashkëlojtarët dhe gjithë ata që kanë qenë bashkudhëtarë në këtë sukses. Unë do të vazhdoj të punoj si gjithmonë dhe ta jap kontributin në cilindo klub që jam i angazhuar", ka thënë Rexha. Sulmuesi në fjalë më pas foli për herë të parë edhe për

vendimin e klubit që ai të lihet i lirë nga klubi i "Niklit". Ai ka thënë për gazetë se e respekton vendimin e klubit, kurse koha do të dëshmojë se kush është në rrugë të drejtë. "Klubi e ka parë të arsyeshëm që unë të lihem i lirë, pasi beson se i duhen lojtarë të tjerë për të ardhmen. Unë i respektoj vendimet e klubeve dhe koha do të dëshmojë se ka apo jo të drejtë", ka shtuar ai. I pyetur se a është befasuar nga ky vendim i klubit, sulmuesi më i mirë në vend, ka deklaruar: "Po, normalisht. Në bazë të asaj se kam treguar dhe po vazhdoj të tregoj, është vendim për t'u çuditur. Mezi pres të filloj një aventurë të re, me synimet e vjetra, për të fituar edhe tituj".

**SHKURT**

## Hertha e ka seriozisht interesimin për Xhakën

Ekipi gjerman Hertha Berlin po mendon ta rikthejë në Bundesligë mesfushorin e Arsenalit, Granit Xhaka. Shqiptari nuk do të qëndrojë më në Londër dhe dëshiron largimin që në janar. Hertha është futur fort në garë për t'i siguruar shërbimet e tij. Kalimi i Xhakës në skuadrën e vogël gjermane mund të jetë një hap mbra-pa për lojtarin, por atij i është premtuar se do të ketë investime për të ardhmen. Analisti i "Sky", Lothar Matthaus, pranoi se Xhaka ishte kontaktuar. "Kam marrë informacione se Xhaka është kontaktuar dhe Preetz ka udhëtuar drejt Londrës". Drejtori i Herthes, Michael Preetz, e pranoi diçka të tillë: "Po udhëtoj shumë. Ne kemi disa opsione dhe ide që i duam në janar".

## Galatasaray nuk heq dorë nga transferimi i Shaqirit

Klubi i madh turk, Galatasaray, është gati ta bëjë të pamundurën për transferimin e sulmuesit shqiptar të Liverpoolit, Xherdan Shaqiri. Sipas mediumit turk "Fanatik", drejtuesit e Galatasarayit janë të sigurt se mund ta transferojnë reprezentuesin e Zvicrës në Turqi muajin e ardhshëm. Galatasaray shpreson ta marrë yllin shqiptar në një huazim fillestar gjashtëmuor, pastaj në verë ta shohë nëse është e nevojshme blerja përfundimtare. Ky transferim nuk do të jetë i lehtë që të realizohet për faktin se Shaqiri ka konfirmuar disa herë se nuk do të largohet nga Liverpooli.

## Venetski rikthehet te KHF Istogu

Hendbollistja e përfaqësueses gjeorgjiane Ketevan Venetski është rikthyer te skuadra kampione e Kosovës, Istogu. Venetski qëndroi jashtë fushës për një vit për shkak të lëndimit që kishte pësuar në ndeshjen kundër skuadrës italiane Casano Magnago që istogaset e kishin fituar për ta futur sportin istogas në anale të historisë. Venetski ka lënë mbrapa lëndimin dhe është rikthyer te skuadra në momentin më të duhur për kampionet pas disa largimeve këtë vit. Trajneri Faruk Shala tani është më i qetë pasi që ka një mundësi më shumë që mëton titullin e dytë radhazi ta sjellin në qytetin e kampioneve në Istog.

## Mezani: Tifozët në Kosovë nuk shajnë

Trajneri aktual i Gjilanit, Gentian Mezani, në "Zona Gol" ka treguar edhe ndryshimin mes kampionatit në Kosovë dhe atij në Shqipëri, sa iu përket ekipeve që ka drejtuar në karrierë. "Presioni është i madh kudo që të shkosh. Por nëse flasim për një ndryshim, në Kosovë nuk të ndërhyjnë presidenti i klubit apo faktorë të jashtëm. Madje edhe kur humbet ka shumë motivim për futbollistët, ndryshe nga ekipet që kam drejtuar në Shqipëri. Tifozët në Kosovë janë shumë të pranishëm në stadium. Unë dua t'u bëj thirrje edhe tifozëve në Shqipëri që ekipi të mbështetet jo vetëm në situatë të mirë, por sidomos duhet të bëhet kjo gjë në çast të keq. Kjo ka ndodhur te Gjilani, kanë ardhur në stadium kur ne ishim në zonën e ftohtë. Madje edhe gjatë stërvitjeve. Këtu tifozët nuk shajnë, ose më mirë shajnë pak. Isha te Flamurtari në stadium para një jave dhe pashë që tifozët e kishin braktisur fare. Nuk duhet kjo sjellje, por bashkë me ta të kalohet gjendja e vështirë", ka thënë Mezani.

## Pioli: Ky nuk mund të jetë Milani i vërtetë

MILANO, 22 DHJETOR - Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, e ka pranuar se skuadra e tij gaboi në gjithçka që prej fillimit të ndeshjes e deri në fund ndaj Atalantës (5-0). Josip Iliqiçi me dy gola, Alejandro Gomez, Mario Pasaliq dhe Luis Muriel

me nga një i ndihmuan Atalantës ta shkatërrojë Milanin dhe ta mbyllë në mënyrë festive vitin 2019 të dielën në Bergamo. Milani e mbylli vitin 2019 me humbjen më të thellë në histori të klubit që prej vitit 1998, kur ishte dërrmuar 5-0 nga Roma.

"Është e qartë se ky nuk mund të jetë Milani i vërtetë, sepse ne treguam paraqitje të forta në ndeshjet e kaluara. Edhe ne duhet ta marrim një pjesë të fajit, sepse bëmë gabime dhe duhet të punojmë. Këta nuk mund të jemi ne", ka thënë

Pioli. "E nisëm ndeshjen pa përkushtimin e duhur dhe pa mprehtësi. Kur e ke qasjen gabim, është e vështirë të rikthehesh. I lejuam shumë hapësirë Atalantës, e cila është në mesin e skuadrave më të mira në Itali, madje edhe në



Evropë sa i përket intensitetit dhe agresivitetit", ka shtuar Pioli.

## Prishtina, kampione vjeshtore në basketboll



PRISHTINË, 22 DHJETOR - KB Sigal Prishtina e ka mposhtur Golden Eagle Yllin në udhëtim me rezultat 79-82 (15-17, 26-25, 18-23, 20-17) në kuadër të javës së 18 të Superligës së Kosovës në basketboll. Me këtë fitore, Prishtina është shpallur kampione vjeshtore me 29 pikë. Çereku i parë ishte i barabartë dhe përfundoi me rezultat 15-17 për prishtinasit. Edhe periudha e dytë ishte shumë e barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shpërbente në epësi

dhe përfundon 26-25 për therandasi. Në periodën e tretë, kryeqytetasit ishin më të mirë dhe fitojnë me rezultat 18-23. Dhjetëminutëshi i fundit ishte shumë interesant dhe i barabartë. Edhe pse Ylli e fitoi këtë çerek 20-17, nuk arriti ta shmangë humbjen dhe në fund Sigal Prishtina triumfon me rezultat 79-82. Prishtina e përfundon stinorin vjeshtor me 13 fitore dhe tri humbje, kurse Golden Eagle Ylli me 10 fitore dhe gjashtë humbje. Skuadra e Pejës e

ka fituar derbin e javës, duke mundur në udhëtim Rahovecin me rezultat 95-109 (24-19, 26-34, 23-23, 22-33) në kuadër të xhiros së 18 të Superligës së Kosovës në basketboll, derisa kjo ishte ndeshja e fundit për stinorin vjeshtor. Te Rahoveci u dalluan Darell Davisi me 30 pikë, shtatë kërcime dhe tetë asistime dhe Joshua McFolley me 24 pikë, derisa te Peja u dalluan Nigel Johnson me 32 pikë e tetë asistime dhe Drilon Hajrizi me 24 pikë e nëntë kërcime.

### SUPERLIGA

Trepça - Lipjani	102-56
Ylli - Sigal Prishtina	79-82
Bashkimi - Feronikeli	91-93
Rahoveci - Peja	95-109

### TABELA

1. Prishtina	29 pikë
2. Rahoveci	27
3. Bashkimi	27
4. Ylli	26
5. Ponte Prizereni	25
6. Peja	25
7. Feronikeli	21
8. Trepça	20
9. Lipjani	16

## Fitojnë Clippersat dhe Rocketsi

SAN ANTONIO, 22 DHJETOR - Viojnë ulje-ngritjet për San Antonio Spursin në këtë sezon të NBA-s. Skuadra teksane pësoi një tjetër humbje këtë herë me rezultat in e thellë 109-134 brenda në "AT&T Center" ndaj Los Angeles Clippersit. Kalifornianët ishin shumë të fortë për skuadrën e Gregg Popovitchit që pësoi humbjen e 17-të sezonale, ndërkohë që Clippersi regjistroi fitoren e 22-të në 31 ndeshje. Paraqitje pozitive e ishit të madh të sfidës Kawhi Leonard, autori i 26 pikëve për skuadrën nga Los Angelesi. Mori fitoren e 3-të rresht dhe të 5-n në 6-të takimet e fundit Houston Rockets që iu fal yllit të saj James Harden për ta mposhtur me rezultat in 125-139 në udhëtim e Arizonas, Phoenix Suns. Me 47 pikë, 6 rebounde dhe 7 asistime, James Harden rezultoi basketbollisti më i mirë mbi parket, ndërkohë një paraqitje të mirë bëri për



skuadrën teksane edhe Rusell Westbrook, i cili koleksionoi 30 pikë, 4 rebounde dhe 10 asistime. Giannis Antetokounmpo realizoi një tjetër triple-double, ndërkohë që Milwaukee Bucks mori fitoren e 26-të në 30 takime pasi kaloi New York Knicks në transfertë me shifrat 102-123. 22 pikë, 11 rebounde dhe 10 asistime koleksionoi Giannis

Antetokounmpo, ndërkohë që në këtë fitore të Bucksit luajti një rol të rëndësishëm edhe Middletoni, autor i 23 pikëve. U rikthye te sukcesi edhe Brooklyn Netsi që kaloi me shifrat 122-112 Atlanta Hawks, pavarësisht prej paraqitjes super të talentit Trae Young në radhët e skuadrës nga Georgia me këtë të fundit që koleksionoi në total 47 pikë.

### SHKURT

#### Tri klube italiane në ndjekje të Kumbullës

Gjigantët italianë të Serisë A, Inter, Milan dhe Juventus, po e synojnë transferimin e qendërmbrojtësit të ri të Hellas Veronas, shqiptarit Marash Kumbulla. 19-vjeçari po kalon në një formë të jashtëzakonshme në ekipin e tij i cili ka 11 paraqitje në të gjitha garat, e duke shënuar edhe një gol. Kjo performancë e tij nuk ka kaluar pa u vënë re nga ekipe si Inter, Milan e Juventus, të cilët po e monitorojnë progresin e Kumbullës dhe pritjet janë që do të bëjnë një ofertë për të në të ardhmen e afërt.

#### Flick, trajner i Bayernit deri në fund të kampionatit

Hansi Flick do të jetë trajner i Bayern Munchenit deri në fund të sezonit 2019/2020. Flick është shprehur i lumtur se ka marrë besimin drejtuesve të klubit dhe është zotuar se do të punohet fuqishëm në fazën përgatitore për të sjellë fitore dhe trofe në Munchen. "Jam i lumtur për besimin e klubit, po e shijoj punën me lojtarët dhe stafin. Jemi vendosur në një pozicion të mirë për fazën e dytë dhe tani do t'i mbushim bateritë e do të përgatitemi intensivisht në fazën përgatitore për të sjellë sa më shumë fitore dhe trofe në Munchen", ka thënë Flick.

#### Chelsea e bën Sanchon transferimin më të shtrenjtë në Premierë Ligë

Skuadra e Chelseat duket se e ka marrë seriozisht rikthimin në merkato, pasi në verë klubi ishte i dënuar. Siç raportohet së fundmi nga "The Sun", blutë e Londrës janë pranë mbylljes së marrëveshjes me Borussia Dortmundin për kalimin e Jadon Sanchos në "Stamford Bridge". Gjithçka do të mbyllet për 120 milionë sterlina, me Sanchon që do të shndërrohet në blerjen më të shtrenjtë të historisë së Premierë Ligë. Anglezi pritet që ta firmosë për Chelsean muajin e ardhshëm.

#### Tuchel: Neymari dhe Mbappe motivojnë njëri-tjetrin

Trajneri Thomas Tuchel është shprehur i kënaqur me paraqitjet e Neymarit dhe Kylian Mbappes. PSG-ja mori tri pikë të reja nga përballja me Amiensin, në një ndeshje ku Mbappe e Neymarit shkëlqyen, por edhe sulmuesi tjetër Mauro Icardi. "Ata luajnë shumë mirë së bashku. Ata kanë rifituar vetëbesimin dhe janë në formë të mirë, kjo është gjëja më e rëndësishme. Neymari motivon Mbappen dhe Mbappe motivon Nemyarin, kjo është e mirë. Sfidat është që të mbajmë këtë shpirt dhe mënyrë loje", ka thënë Tuchel.

#### Klopp: Ndjenjë e shkëlqyeshme të jesh kampion bote

Jurgen Klopp ka folur pas shpalljes së Liverpoolit kampion bote për klube pas fitores 1-0 në finale ndaj Flamengos. "Është e shkëlqyeshme, me të vërtetë ndjenjë e shkëlqyeshme të shpallësh kampion bote. Të gjithë jemi të lodhur nga një lojë me të vërtetë intensive. Kemi pasur disa çaste në të kaluarën kur me të vërtetë përpiqem t'i gjej fjalët e duhura në gjuhën time joamtare për ta përshkruar respektin tim për djemtë", ka thënë Kloppi. "Është e jashtëzakonshme, ishte një paraqitje e jashtëzakonshme, në një ndeshje tepër të vështirë kundër një kundërshtari të mirë. Por, ne bëmë shumë gjëra të mira. Është e pabesueshme, aq shumë momente të mira futbolli. Të gjithë ishin për arsye të ndryshme në avantazh, por pashë aq shumë paraqitje të mira sensacionale dhe jam vërtet i lumtur natyrisht për përkrahësit tanë", ka deklaruar Kloppi.

Trajneri gjerman ka thënë se tifozët e Flamengos duhet të jenë krenarë për ekipin e tyre, ani pse e humbi finalen ndaj "Reds". "Atmosfera në stadium ishte e shkëlqyeshme, përkrahësit e Flamengos kishin gjithë këtë javë, një javë feste këtu dhe, për fat të keq, ndoshta nuk mund të festojnë aq shumë, por ata duhet të jenë krenarë për atë që bënë dhe atë që bëri ekipi i tyre. Mendoj se meritua të fitonim, ne ishim skuadër më e mirë. Në disa çaste kemi pasur një portier vërtet të mirë dhe në të gjitha çastet e tjera ishim skuadra mbizotëruese. Jam vërtet i lumtur", ka përfunduar Kloppi.

U bënë dy vjet pa më të dashurin tonë



# **Prof. Sadik Miroci**

(1942-2017)

U ndave nga ne fizikisht, por nga zemrat tona për asnjë sekondë. Do të kujtojmë deri në ditët e fundit babai ynë. **E përkujtojnë mbarë familja Miroci.**

RESTAURANT

---

**SWISS**



---

TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË


  **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



 [www.facebook.com/giejpuneshpejte](http://www.facebook.com/giejpuneshpejte)

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



## Auto Shkolla "RITMO - L" Prishtinë

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

# SIGMA



## VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)